

FJALOR I TERMINOLOGJISË TREGTARE DHE DOGANORE

Fjalori tregtar përmban terminologjinë që zakonisht përdoret në tregtinë ndërkombëtare, duke siguruar parashikueshmeri në përdorim, dhe krijimin e qartësisë shtesë për ata që angazhohen në transaksionet tregtare."

AD - VALOREM TATIMET DHE DETYRIMET

- Detyrimet dhe tatimet që llogariten në bazë të përqindjes së vlerës së mallit.

AEROPORT NDËRKOMBËTAR

- Aeroport i përcaktuar si port i hyrjes ose i daljes për aeroplanët civil dhe mallit që bartet me të. Përfshirja e termit "ndërkombëtar" në emrin e aeroportit nuk do të thotë domosdoshmërisht që aeroporti është aeroport ndërkombëtar i përcaktuar për qëllime të Doganave.

AGJENT DOGANOR (Shpediter)

- Person ose kompani që merret me organizimin profesional të transportit të mallrave në emër të tij e për llogari të pales.
- Person ose kompani që merret drejtpërdrejt me Doganën, për dhe në emër të një personi tjetër, në lidhje me importin, eksportin, tranzitimin, lëvizjen ose magazinimin e mallrave.

AKREDITIMI

- Akreditimi është procedura e pranuar ndërkombëtarisht që njeh kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues, organeve çertifikuese të produktit, organeve të certifikimit të sistemeve të cilësisë dhe organeve të inspektimit. Akreditimet minimizojnë duplikimin e rritimeve dhe ricertifikimeve, eliminojnë barrierat jotarifore për tregti dhe zvogelojnë koston dhe vonesat e çasjes në treg.

ANKESA

- Akti me të cilin një person (fizik ose juridik) që është drejtpërdrejt i ndikuar nga ndonjë vendim apo gabim i autoriteteve qeveritare dhe i cili gjykon se është dëmtuar dhe për këtë kërkon kompensim para autoriteteve kompetente.

ARRESTIMI

- Kapja apo mbajtja e personit nga zyrtari zbatues i ligjit që shkon përtej marrjes së shkurtër në pyetje. Zakonisht përfshin ngritjen formale të padisë kundër personit të kapur.

ARTIKUJT POSTAR

- Posta është menyre e popullarizuar për dërgimin e shkresave me pliko dhe të sasive të vogla të mallrave në pako ndërkombëtarisht. Këto njihen si artikuj postar.

ASISTENCA E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE

- Masat e ndërmarra nga Administrata Doganore në emër të apo për bashkëpunim me një administratë tjetër Doganore, me qëllim të zbatimit të mirëfilltë të ligjit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve doganore.

ASOCIACIONI EMETUES

- Një asociacion që është i aprovuar nga Autoritetet Doganore për lëshimin e karneteve ATA, CPD dhe TIR dhe i cili është i lidhur direkt apo indirekt me zinxhirin garantues.

AUTOMJET

- Do të thotë makinë mobile e projektuar dhe përdorur për transportim të pasagjerëve dhe ngarkesave. Automjetet mund të përfshijnë çdo fluturake, tren, veturë, furgon, kamion, qerre ose ndonjë lloj tjetër i mjeteve bartëse qfarëdolloji qoftë dhe përfshin pajisjet, orenditë dhe aparaturën e tyre.

AUTORIZIM I PËRFAQËSIMIT (për Dogana)

- I jepet një punonjësi, agjencie doganore, përfaqësuesi, partneri apo zyrtari korporate për të kryer punë në doganë në emër të importuesit apo eksportuesit.

BAGAZHI PERSONAL

- Gjëra personale të importuara, në lidhje me arritjen e personit dhe zakonisht me qëllim të përdorimit personal.

BAGAZHI SHOQËRUES

- Artikujt që barten me aeroplanin, anijen apo automjetin e njëjtë si edhe pasagjeri. Bagazhi që arrin me formën e njëjtë të transportit, para apo pas pasagjerit, duhet të trajtohet si bagazh që e shoqëron atë nëse qëllimi i pasagjerit ka qenë që bagazhi të arrijë me të por është drejtuar gabimisht pa fajin e pasagjerit.

BANOR I KTHYER

- Personi që kthehet nga diaspora, i cili më parë ka banuar në vend dhe që nuk e ka braktisur selinë e tij në Kosovë.

BANORËT E ZONËS KUFITARE

- Personat e vendosur apo banorët në zone kufitare.

BARRIERAT TEKNIKE PËR TREGTI

- Barrierat teknike për tregti janë barriera jotarifore që mund të rezultojnë nga përgatitja, miratimi dhe zbatimi i rregulloreve të ndryshme teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit ose restriksione tjera të ngjashme.

BARTËSI

- Personi që transporton ose është përgjegjës për operimin e mjeteve të transportit.

BARTËSI I SË DREJTËS

- Do të thotë personi që ka të drejtën të shfrytëzojë një objekt të pronës intelektuale në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

BILANCI I PAGESAVE BAZË

- Të dhëna tregtare që janë konform me metodat e të ardhurave kombëtare të kontabilitetit (vlera e tregtisë në mallra dhe shërbime midis banorëve dhe jo-banorëve ndonjëherë pa kalimin e kufijve), shifrat për mallrat tregtare që janë nxjerrë dhe rregulluar nga të dhënave doganore (vlera e mallrave të tregtisë për kalimin e kufijve).

BORXHI DOGANOR

- Nënkupton obligimin që ka një person për të paguar shumën e detyrimeve dhe tatimeve të importit (borxh doganor në importim) apo detyrimeve dhe tatimeve doganore të eksportit (borxh doganor në eksportim), që zbatohen për mallra të caktuara sipas dispozitave ligjore të Kosovës që janë në fuqi.

CEFTA

- Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore, amendamentuar në vitin 2006.

ÇERTIFIKATA E ORIGJINËS

- Dokument specifik që identifikon mallin, me të cilin autoriteti apo organi i autorizuar për ta lëshuar vërteton qartë se mallrat të cilave u referohet çertifikata kanë origjinën nga një vend specifik. Kjo certifikatë gjithashtu mund të përfshijë një deklaratë nga përpunuesi, prodhuesi, furnizuesi, eksportuesi ose personat tjerë kompetent.

CERTIFIKATA E PERCAKTIMIT RAJONAL

- Vërtetim i hartuar në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoriteti apo organi i miratuar, që vërteton se mallrat e përshkruara në të kualifikohen për titull specifik të rajonit të caktuar (p.sh. Shampanjë, Verë Port, Djath Parmezan).

ÇERTIFIKIMI

- Bazuar në rezultatet nga laboratorit apo organi i akredituar dhe specifikimet nga një standard dokumentar, certifikimi është operacioni që ka për qëllim të sigurojë konformitetin e produkteve,

shërbimeve etj, përmes vlerësimit teknik të përbërë nga kombinimet e duhura të operacioneve të përcaktuara.

CERTIFIKIMI I PRODUKTEVE

- Certifikimi i produktit mund të përbëhet nga testimi fillestar i një produkti kombinuar me vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së furnizuesit. Kjo mund të përcillet me mbikqyrjen që merr parasysh sistemin e menaxhimit të cilësisë së furnizuesit dhe testimin e mostrave nga fabrika dhe/ose nga tregu i hapur. Skema të tjera të certifikimit të produktit përfshijnë testimin fillestar dhe testimin mbikqyrës, përderisa disa tjera varen në testimin e mostrave të produkteve – kjo njihet si testim i llojit.

CFR (KOSTO DHE PAGESA E TRANSPORTIT)

- Kosto dhe pagesa e transportit do të thotë që shitësi duhet të paguajë koston dhe pagesën e transportit, të domosdoshme për t'i sjellë mallrat në portin e dëshiruar por rreziku i humbjes apo dëmtimit të mallrave si dhe çfarëdo kostoje shtesë për shkak të ngjarjeve që mund të ndodhin pasi që mallrat janë dorëzuar për ngarkim në lundër, bartet nga shitësi te blerësi kur mallrat i kalojnë binarët e lundrës në portin prej ku dërgohen. CFR kërkon që shitësi t'i përgatit mallrat për eksport. Ky term mund të përdoret vetëm për transport përmes detit dhe rrugëve tjera ujore.

CIF (KOSTO , SIGURIMI DHE PAGESA E TRANSPORTIT)

- Kosto, sigurimi dhe pagesa e transportit do të thotë që shitësi ka të njëjtat obligime sikurse me CFR por i shtohet edhe ajo se ai duhet të prokurojë sigurimin e marinës ndaj rrezikut të blerësit për humbje apo dëmtim të mallit gjatë transportit. Shitësi e kontraktin sigurimin dhe paguan preminë. Blerësi duhet ketë vëmendjen se sipas kushteve të CIF shitësit i kërkohet të bëjë sigurimin vetëm me mbulesë minimale. CIF i kërkon shitësit që t'i përgatisë mallrat për eksport. Ky term mund të përdoret vetëm për transport përmes detit dhe rrugëve tjera ujore.

ÇMIMI I TRANSFERIT

- I referohet çmimeve apo sistemeve të çmim-vënies të përdorura në transaksione midis palëve.

ÇMIMI NETO

- Çmimi pasi janë hequr të gjitha zbritjet, lirimet, rabatet etj.

ÇMIMI REALISHT I PAGUAR APO PER PAGESE

- Pagesa e plotë, e bërë qoftë direkt apo indirekt, apo që do të bëhet nga blerësi për mallin e importuar, për ose në dobi të shitësit.

CODEX ALIMENTARIUS

- Ky është një koleksion i standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, kodeve të praktikës, udhëzuesve dhe rekomandimeve tjera lidhur me ushqimet, prodhimin e ushqimit dhe sigurinë e ushqimit. Ishte zhvilluar dhe mbahet nga Codex Alimentarius Commission, organ i cili është krijuar në fillim të Nëntorit 1961 nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë të Kombeve të Bashkuara (OUB).

Qëllimet kryesore të Komisionit janë mbrojtja e shëndetit të konsumatorëve dhe sigurimi i praktikave të drejta në tregtinë ndërkombëtare me ushqim.

CPT – TRANSPORTI I PAGUAR DERI (vendi i emëruar i destinimit)

- Në Transportin e Paguar deri te, shitësi/eksportuesi/prodhuesi kryen obligimet e mallrave për eksport, i dërgon ato te bartësi, dhe është përgjegjës për pagesën e transportit deri te vendi i emëruar i destinimit. Sidoqoftë, pasi që shitësi të ketë dërguar mallin te bartësi, blerësi bëhet përgjegjës për të gjitha shpenzimet shtesë. Shitësi nuk është përgjegjës për prokurimin dhe pagimin e mbulimit të sigurimit. Termi CPT mund të përdoret te të gjitha llojet e transportit duke përfshirë edhe atë multimodal.

DAF – DËRGUAR NË KUFİ (vendi i emëruar)

- Dërguar në Kufi, shitësi/eksportuesi/prodhuesi kryen obligimet e mallit për eksport dhe është përgjegjës për të bërë mallin të mundshëm për blerësin në vendin e emëruar në kufi, të pazbarkuar dhe jo të zhdoganuar për import. Për termin DAF, emërimi i pikës të saktë, vendit dhe kohës së dispozicionit në kufi është shumë i rëndësishëm sepse blerësi duhet të aranzhojë zbarkimin dhe sigurimin e mallit në kohë. Kufi do të thotë çdo kufi duke përfshirë edhe kufirin për eksport. Termi DAF mund të përdoret për të gjitha llojet e ngarkesave, përderisa dërgesa e fundit e vendit të emëruar është në kufi tokësor. Shitësi nuk është përgjegjës për prokurimin dhe pagimin e mbulimit të sigurimit.

DAMPING

- Importimi i mallit brenda vendit me çmim eksporti që është më i vogël se vlera normale në vendin ku prodhohen mallrat.

DATA E EKSPORTIMIT

- Data kur një mall nisat nga vendi. Nëse lundra me mall në bord nisat prej dy apo më shumë porteve të vendit të eksportimit, data kur lundra largohet përfundimisht nga porti i fundit i vendit eksportues është data e eksportimit. Kur malli transportohet nga një vend i brendshëm përmes porteve të një vendi tjetër atëherë data e eksportimit është data kur malli e kalon kufirin e vendit eksportues.

DATA E SKADIMIT (Dogana)

- Data kur pagesa e detyrimeve dhe tatimeve skadon

DDP – DËRGUAR ME ZHDOGANIM (...vendi i emëruar i destinimit)

- Dërguar me Zhdoganim, shitësi/eksportuesi/prodhuesi kryen obligimet e mallit për eksport dhe është përgjegjës për të bërë mallin e mundshëm për blerësin në vendin e emëruar të destinimit dhe zbarkimin prej mjetit transportues. Shitësi, si rezultat, pranon të gjitha përgjegjësitë për dërgimin e mallrave në vendin e emëruar të destinimit, përfshirë të gjitha përgjegjësitë për zhdoganimin e importit, obligimet doganore dhe shpenzimet tjera të pagueshme për import. Termi DDP mund të përdoret për çdo formë të transportit.

DDU – DËRGUAR PA ZHDOGANIM (...vendi i emëruar i destinimit)

- Dërguar pa Zhdoganim, shitësi/eksportuesi/prodhuesi kryen obligimet e mallit për eksport dhe është përgjegjës për të vëre mallin në dispozicion të blerësit në vendin e emëruar të destinimit, jo të zhdoganuar për import. Shitësi, si rezultat, pranon të gjitha përgjegjësitë për dërgimin e mallrave në vendin e destinimit, por blerësi merr të gjitha përgjegjësitë për zhdoganimin e importit, obligimet doganore, shpenzimet administrative dhe të gjitha shpenzime tjera të importit sikurse edhe transportin deri në pikën e fundit të destinimit. Termi DDU mund të përdoret për çfardo forme të transportit. Termi DDU përdoret kur vendi i destinimit (pika e dorëzimit) nuk është në port detar apo aeroport.

DEFTESË OBLIGIMI PËR TRANZIT

- Dokument i Doganave shtetërore që siguron autoritetin që mallrat mund të barten në tranzit Doganor pa pagesë paraprake të detyrimeve të importit dhe tatimeve, që përgjithësisht përmban të gjitha të dhënat e domosdoshme për vlerësim, kur është e përshtatshme, të detyrimeve të importit dhe tatimeve, dhe një veprim, të mbuluar me siguri, për t'i paraqitur mallrat në Zyrën Doganore të Destinacionit me vulë Doganore të paprekur.

DEKLARUESI

- Cilido person fizik apo juridik që bën deklaratë doganore apo në emër të të cilit bëhet një deklaratë e tillë.

DEKLARATA DOGANORE E mallrave

- Deklaratë nga importuesi apo eksportuesi për të llogaritur mallrat e importuara apo eksportuara, e cila në cilindo rast, nëse kërkohet të jetë me shkrim bëhet në një formular deklarimi doganor, ku importuesi apo eksportuesi tregon procedurën e veçantë doganore që do të aplikohet dhe jep të dhënat që kërkohen për aplikim të kësaj procedure.

DEKLARATA E ARRITJES APO NISJES

- Çfarëdo deklarate që kërkohet të bëhet apo ti paraqitet autoriteteve doganore, me rastin e arritjes apo nisjes së mjeteve të transportit ,nga personi përgjegjës për mjetet e transportit apo agjenti i tij dhe që përmban të dhënat e domosdoshme në lidhje me mënyrën e transportit dhe itinerarin, ngarkesën, depot, ekuipazhin apo udhëtarët.

DEKLARATA E EKSPORTIT

- Paraqitja formale që i bëhet Doganës në portin e daljes në deklaratën doganore të mallrave me të dhënat e plota për mallrat që eksportohen.

DEKLARATA E mallrave NË DOGANË apo DEKLARATA DOGANORE

- Çdo deklaratë apo veprim i çfarëdo forme i përshkruar apo pranuar nga Doganat që jep informata apo të dhënat e kërkuara nga Doganat.

DEKLARATA E NGARKESËS

- Term i përgjithshëm, ndonjëherë i referuar si deklaratë mallrash, i aplikuar në dokumentet që ofrojnë të dhëna mbi veçoritë e ngarkesave (mallrave) që barten nga mjetet komerciale të transportit.

DEKLARATA E ORIGJINËS

- Deklaratë e duhur për origjinën e mallrave, në lidhje me eksportimin e tyre, e bërë nga prodhuesi, kultivuesi, furnizuesi, eksportuesi apo personi tjetër kompetent, në faturën komerciale apo në ndonjë dokument tjetër që ka të bëjë me mallrat. Kjo mund të jetë certifikatë e origjinës.

DEKLARATA E PËRGJITHSHME E AEROPLANIT

- Deklarata në pajtim me dispozitat e Aneksit 9 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Çikago 1944. Deklarata e përgjithshme është dokumenti themelor i arritjeve dhe nisjeve që përmban informata për vet aeroplanin dhe informata të përmbledhura në lidhje me itinerarin, ekuipazhin, pasagjerët dhe shëndetin.

DEKLARATA E PËRGJITHSHME E ANIJES

- Deklarata (IMCO FAL Forma1) në përputhje me dispozitat e Aneksit të Konventës për Lehtësimin e Trafikut Detar, Londër 1965. Deklarata e përgjithshme është dokumenti bazë për mbërritjen dhe nisjen që siguron informata në lidhje me vetë anijen dhe informata përmbledhëse në lidhje me ngarkesat, ekuipazhin, udhëtarët apo lundrimin.

DEKLARATA E REZERVAVE

- Dokument që ofron të dhëna sa i përket rezervave të bartura në bord të mjetit transportues, që do t'i prezentohet Doganave sipas kërkesës.

DEKLARATA E VËRTETUAR E ORIGJINËS

- Deklaratë e origjinës e vërtetuar nga autoriteti apo organi i autorizuar për ta bërë këtë.

DEKLARATA NDËRKOMBËTARE DOGANORE FORMA TIF

- Dokument që përdoret për mallrat dhe bagazhin gjatë tranzitit doganor përmes hekurudhës i paraqitur nga dy konventat ndërkombëtare për lehtësimin e kalimit të kufijve të nxjerrura në Gjenevë me 10 janar 1952:

(1) Për mallra që barten përmes hekurudhës, dhe

(2) Për udhëtarë dhe bagazh që barten përmes hekurudhave,

Përfshin një përshkrim të shkurtër të mallrave dhe bagazhit si dhe ndërmarrjen e tyre nga hekurudhat në vendin e destinimit me vullë doganore të paprekur.

DEPO E BRENDSHME ZHDOGANIMI

- Zyrë e brendshme doganore kombinuar me objekt të përdoruesit të zakonshëm që nuk është port, aeroport apo stacion rrugor apo hekurudhor, me apo pa status të autoritetit publik, i pajisur me instalime fikse dhe që ofron shërbime të trajtimit dhe magazinimit të përkohshëm të çfarëdo lloji malli (përfshirë konteinerët) që barten nën tranzit doganor me cilindo formë të aplikueshme të transportit, të vendosura nën kontroll doganor dhe me Doganë apo agjencione tjera kompetente për të zhdoganuar mallrat për përdorim vendor, magazinim, hyrje të përkohshme, ri-eksportim, magazinim të përkohshëm apo transit që shkon tutje dhe eksport të drejtpërdrejtë.

DEPO E KONTEINERËVE

- Do të thotë depo e konteinerëve për deponim të mallrave të importuara në konteiner, në pritje të lirimit nga kontrolli doganor.

DEPO TRANZITI

- Do të thotë, vend për deponimin e mallrave të importuara nën kontroll doganor, në pritje të raportimit të mallrave të tilla në zyrat doganore dhe zbatimit pasues të procedurave doganore.

DEPOZITI

- Shumë parash e paguar përkohësisht (Frëngjisht: "consignation"), apo tituj pronësie, bono bartëse, etj, e dorëzuar si sigurim për pagesën e detyrimeve dhe tatimeve të tilla apo shumëve dhe obligimeve tjera që mund të bëhen të detyrueshme.

DEQ – DËRGUAR FRANKO BREGU I DETIT (... limani i emeruar i destinimit)

- Në Dërguar Franko Bregu i Detit, shitësi/eksportuesi/prodhuesi kryen obligimet e mallit për eksport dhe është përgjegjës për të bërë të mundshëm mallin blerësit në bregdet, te limani i destinimit, jo të zhdoganuar për import.

Blerësi, si rezultat, pranon të gjitha përgjegjësitë për zhdoganimin e importit, obligimet doganore dhe shpenzimet tjera të importit sikurse edhe transportin deri në pikën finale të destinimit.

DEQ termi përdoret vetëm për ngargesat e mallrave të cilat arrijnë në portin e destinimit përmes detërave apo ujërave tokësorë.

DËRGESA

- Mall i dërguar te shitësi me pakicë i cili pritet të paguaj pas shitjes.

DËRGESAT URGJENTE

- Mallra që kërkojnë zhdoganim të shpejtë si çështje prioritare për shkak:
të natyrës së tyre,
se janë dërgesa humanitare
se plotësojnë nevoja urgjente plotësisht të arsyeshme

DES – DËRGUAR FRANKO ANIJE (...limani i emëruar i destinimit)

- Në Dërguar Franko Anije, shitësi/eksportuesi/prodhuesi zhdoganon mallin për eksport dhe është përgjegjës që ta bëjë mallin të mundshëm për blerësin në bord të anijës në limanin e emëruar të destinimit, të pa-zhdoganuar për import.

Andaj, shitësi është përgjegjës për të gjitha shpenzimet e mallit deri në limanin e emëruar të destinimit, para shkarkimit.

Termi DES përdoret vetëm për mallrat që transportohen nga rrugët detare apo ujërave toksore ose përmes formave multimodale të transportit, ku dërgesa finale është kryer në anije tek limani i emëruar i destinimit.

DESHMIA

- Çfarëdo çështje apo fakt prej të cilit mund të nxirret një konkluzion në lidhje me një çështje apo fakt tjetër.

DESHMIA E DOKUMENTUAR E ORIGJINËS

- Certificate e origjinës, deklaratë e certifikuar e origjinës ose deklaratë e origjinës ose dokumente tjera me prirje për të provuar origjinën.

DETYRIMET DHE TATIMET (Dogana)

- Detyrimet dhe tatimet e importit dhe/ose detyrimet dhe tatimet e eksportit.

DETYRIMET DHE TATIMET E EKSPORTIT (Dogana)

- Detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet, tatimet, pagesat dhe ngarkesat tjera që mblidhen në lidhje me eksportimin e mallrave, por nuk përfshihen pagesat dhe shpenzimet që janë të kufizuara në sasi të përafërt me koston e shërbimeve të ofruara.

DETYRIMET DHE TATIMET E IMPORTIT DHE EKSPORTIT

- Detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet, tatimet, pagesat dhe shpenzimet tjera që mblidhen në lidhje me importimin apo eksportimin e mallrave, por nuk përfshihen pagesat dhe shpenzimet që janë të kufizuara në sasi të përafërt me koston e shërbimeve të ofruara.

DETYRIMET DHE TATIMET SPECIFIKE

- Detyrimet dhe tatimet të cilat janë llogaritur në bazë të sasisë apo njësive matëse.

DETYRIMET DOGANORE

- Detyrimet e vendosura me tarifa doganore, të detyrueshme për mallrat që hyjnë apo që lëshojnë territorin e një vendi.

DETYRIMET E EKSPORTIT

- Nënkupton të gjitha detyrimet doganore, duke përfshirë pagesat që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore dhe taksat e pagueshme me rastin e eksportimit të mallrave nga Kosova, por duke përjashtuar çdo tarifë apo pagesë për transport apo licencë.

DETYRIMET E IMPORTIT

- Nënkupton të gjitha detyrimet doganore, duke përfshirë pagesat të cilat kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore dhe taksat e pagueshme gjatë importimit të mallrave në Kosovë, duke përjashtuar çdo tarifë apo pagesë për transport apo licencë.

DETYRIMI

- Pagesë ligjore caktuar nga Qeveria. Janë katër kategori të detyrimeve: Specifike, Ad Valorem, Kombinuar dhe Liruar nga detyrimet. Ad Valorem është kategori e bazuar në përqindjen e vlerës së tatueshme. Specifike është kategori e detyrimeve e bazuar në shumë të caktuar për çdo njësi të importuar. Kombinuar është kategori e kombinuar nga të dy kategoritë tjera Ad Valorem dhe Specifike. Liruar është kategori e detyrimeve edhe pse nuk ka mbledhje monetare.

DETYRIMI ANTI-DAMPING

- Detyrim i vlerësuar në mallrat e shitura më pak se vlera normale. Detyrimi i vlerësuar është ndryshimi në mes të çmimit të shitjes së mallit ("çmimi i eksportit") në Kosovë dhe çmimit me të cilin mallrat shiten në vend ("vlera normale").

DETYRIMI KUNDËRVEPRUES

- Detyrim shtesë, i barabartë me shumën e dhuratave, subvencioneve apo granteve, të paguara apo dhuruara nga një qeveri e huaj për cilindo artikull apo mall të importuar në vend nga vendet e huaja.

DHURATA

- Artikull që jepet vullnetarisht nga një person personit tjetër pa kompenzim apo premtim për kompenzim.

DISTRIBUTORI

- Agjent i huaj që shet drejtpërdrejt për përpunuesin dhe mban inventar.

DOGANAT

- Shërbim qeveritar përgjegjës për administrimin e ligjeve doganore dhe për mbledhjen e detyrimeve dhe tatimeve të importit dhe eksportit dhe që gjithashtu ka përgjegjësi për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve tjera të lidhura, inter alia, me importimin, tranzitin dhe eksportimin e mallrave dhe zbatimin e ligjit në kufi.

DOKUMENT

- Cdo medium i dizajnuar për të mbajtur dhe që faktikisht regjistron të dhëna dhe informata tjera; duke përfshirë letrën shiritat magnetikë, disqet, mikrofilmat etj.

DREJTORI GJENERAL

- Zyrtari doganor që është udhëheqësi i Doganës së Republikës të Kosovës.

DYQANET DETARE

- Sendet e bartura në bord të lundrave apo fluturakeve siç janë dispozitat dhe suveniret e mbyllura, barnat, kozmetika, duhani, pijet alkoolike, etj.

DYQANET E ANIJES

- Sendet që barten në bord të lundrës apo fluturakes për të cilat nuk paguhen detyrime dhe tatime në asnjë vend.

DYQANET PA DOGANË

- Dyqan nën kontroll doganor, zakonisht ndodhen në porte detare dhe aeroporte, ku një udhëtar që del jashtë vendit apo vjen në vend mund të marrë mallrat e liruara nga detyrimet dhe tatimet doganore.

E DREJTA AUTORIALE

- E drejta ekskluzive për të riprodhuar, publikuar apo shitur lëndë apo formë të punës letrare, muzikore apo artistike.

EFEKTET E EKUIPAZHIT

- Sendet e përdorimit të përditshëm dhe artikujt tjerë që i takojnë ekuipazhit që barten në bord dhe mjete të transportit dhe të cilat mund të kërkohet që të deklarohen në doganë.

EKSPORT

- Në lidhje me mallrat, do të thotë zhvendosja nga Kosova ose ndonjë vend tjetër.

EKSPORTIM I DREJTPËRDREJT

- Shitja nga eksportuesi drjtpërdrejt te blerësi në vend të jashtëm

EKSPORTIM I PËRKOHSHËM ME NJOFTIM PËR QËLLIM TE KTHIMIT

- Eksportimi i mallrave të cilat nga deklaruesi specifikohen se janë me qëllim për t'u ri-importuar, në bazë të të cilit mund të merren masa identifikimi nga Doganat për të lehtësuar ri-importimin në të njëjtën gjendje.

EKSPORTIM I PËRKOHSHËM PËR PËRPUNIM TË JASHTËM

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat që janë në qarkullim të lirë në një territor doganor mund të eksportohen përkohësisht për prodhim, përpunim apo riparim jashtë vendit dhe pastaj të ri-importohen me përjashtim të plotë ose të pjesëshëm nga detyrimet e importit dhe tatimet.

EKSPORTIM I PRERË

- Procedurë doganore që zbatohet për mallrat të cilat, duke qenë në qarkullim të lirë, largohen nga territori Doganor dhe janë të destinuara të mbeten përgjithmonë jashtë tij, duke përjashtuar mallrat e eksportuara me procedurë të tërheqjes, nën procedurë të përpunimit apo me ri pagesën e detyrimeve dhe tatimeve të importit.

EKSPORTIMI

- Akti i nxjerrjes së mallrave jashtë territorit doganor.

EKSPORTUESI

Cilido person i cili në kohën e eksportimit:

- (a) Është pronar i mallrave që eksportohen
- (b) Mban rrezikun për mallrat e eksportuara
- (c) Përfaqëson apo vepron si të ishte ai eksportuesi apo pronari i çfardo malli të eksportuar

(d) Faktikisht merr ose tenton të merr mallrat nga Kosova;

(e) Është i interesuar si përfitues për cilindo mall të eksportuar.

EKUIPAZHI

- Përfshinë çdo person përveç pilotit apo kapitenit në bord të anijes apo fluturakes.

EXW (Ex Works)

- Do të thotë që shitësi përmbush obligimin e tij për t'ia dorëzuar mallrat, kur ti ketë në dispozicion në këto lokale (punë, fabrikë, depo etj), blerësit. Në veçanti ai nuk është përgjegjës për ngarkimin e mallrave në automjetin e siguruar nga blerësi apo për zhdoganim të mallrave për eksport, përveç nëse është rënë në pajtim ndryshe. Blerësi bart të gjitha shpenzimet dhe rreziqet e përfshira në marrjen e mallrave nga lokalet e shitësit dhe dërgimin e tyre në destinacionin e dëshiruar. Ky term pra paraqet obligim minimal për shitësin.

Ky term nuk duhet të përdoret kur blerësi nuk mund ti kryej direkt apo indirekt formalitetet e eksportit. Në raste të tilla duhet të përdoret termi FCA (transportuesi i lirë, emri i vendit të dorëzimit).

FALSIFIKIM

- Zakonisht i referohet mallit të shënuar me markë fabrike false apo jo –originale që është e padallueshme nga marka e regjistruar.

FAS FREE – DËRGUAR PËRBRI ANIJES (...limani i emëruar i dërgesës)

- Në Dërguar Përbri Anijes, shitësi/eksportuesi/prodhuesi zhdoganon mallrat për eksport dhe vendos ato përbri lundrës në limanin e emëruar të dërgesës.

Palët e përfshira në transaksion, megjithatë, mund të përcaktojnë në kontratën e shitjes që blerësi, në vend të shitësit të zhdoganojë mallrat për eksport. Termi standard FAS, megjithatë, kërkon që shitësi të zhdoganojë mallrat për eksport.

FAS termi përdoret vetëm për rrugët detare dhe të ujërat tokësore.

FATURA

- Listë e mallrave të veçanta të dërguara me përshkrimin e tyre dhe vlerën apo çmimet e listuara së bashku me pagesat e lidhura me të. Është regjistrim i transaksionit ndërmjet blerësit dhe shitësit.

FATURA E NGARKESËS

- Një dokument që ofron kushtet e kontratës ndërmjet dërguesit të mallit dhe kompanisë transportuese për lëvizjen e mallrave ndërmjet pikave të caktuara për një pagesë të specifikuar.

FATURA E PRANIMIT NË POSTË

- Dëftesë e nënshkruar nga autoritetet postare për dorëzimin e ngarkesës.

FATURA KOMERCIALE

- Faturë e nënshkruar nga shitësi ose bartësi apo agjenti i tij, që është e pranueshme për doganat nëse është e përgatitur në përputhje me rregullat doganore dhe në mënyrë të zakonshme për transaksione komerciale që përfshijnë mallrat e llojit që mbulohen me faturë.

FATURA PRO-FORMA

- Në rastet kur fatura komerciale nuk është e nevojshme apo është mënjanuar, importuesi mund të paraqesë një faturë pro-forma. Nuk ka formular doganor për faturën pro-forma. Ajo mund të jetë e shkruar me dorë në letër të thjeshtë.

Fatura pro-forma është një dokument komercial i cili është lëshuar nga shitësi me kërkesën e blerësit para faturës komerciale e cila tregon listën e çmimeve dhe pasohet zakonisht nga një kërkesë për blerje nga blerësi. Ajo gjithashtu mund të kërkohej nga bankat kur kanë të bëjnë me letrat e kreditit.

FATURA RRUGORE

- Dokument transporti që përdoret për të kontrolluar transportin e mallit përmes kamionave. Përmban të njëjtat informata si fatura e ngarkesës së brendshme, me taksat e transportit dhe pagesat e tjera, dhe itinerarin.

FATURË E PORTËS

- Faturë që jepet për dërgesën e pranuar apo dorëzuar në mol të anijes. Kur dërgimi i një dërgese të huaj është kompletuar, fatura e portes i lëshohet drejtuesit të lundrës apo agjentit të tij dhe shërben si bazë e përgatitjes së Faturës Oqeanike të Ngarkesës.

FCA – BATRESI I LIRE (...vendi i emëruar)

- FCA, shitësi/eksportuesi/prodhuesi zhdoganon mallin për të eksportuar dhe pastaj i dërgon ato te bartësi i zgjedhur nga blerësi në vendin e emëruar.

Nëse vendi i emëruar është vendi i biznesit të shitësit, shitësi është përgjegjës për ngarkimin e mallrave në mjetin transportues. Nëse vendi i emëruar është ndonjë vend tjetër, sikurse vendi i ngarkimit te bartësi, shitësi nuk është përgjegjës për ngarkimin e mallrave në mjetin transportues.

FCA termi mund të përdoret për çfarëdo forme të transportit, duke përfshirë transportin multimodal.

FIKSIMI

- Fije, spango, tel, shirit apo të ngjashme që përdoren së bashku me vulën.

FLETA RRUGORE

- Një dokument i përgatitur nga një linjë transporti në pikën e dërgesës për përdorim në trajtimin e dërgesës që tregon pikën e origjinës, destinacionin, rrugën për tu ndjekur, dërguesin, marrësin, përshkrimin e ngarkesës dhe shumën e paguar për shërbimin e transportit, dhe shërbimet e tjera të lidhura me transport. Në pikat e informatave është e ngjashme me faturën e ngarkimit.

FLUTURAKE KOMERCIALE

- Fluturake e marrë me qira që bartë pasagjerë apo ngarkesa.

FOB (të lira në bord)

- Do të thotë që shitësi përmbush obligimin për të dorëzuar mallrat, kur ato kalojnë binarët e anijes në portin e emëruar të dërgesës. Kjo do të thotë se blerësi bart të gjitha shpenzimet dhe rreziqet e humbjes apo dëmtimit të mallrave që nga ajo pike.

Termi FOB kërkon nga blerësi t'i zhdoganojë mallrat për eksport

Ky term mund të përdoret vetëm për transport detar apo ujëra tokësore.

FORMALITETET DOGANORE

- Të gjitha operacionet që duhet të kryhen nga personi përkatës dhe nga Doganat për të qenë në përputhje me dispozitat apo provizionet rregulluese për të cilat Doganat janë përgjegjëse për t'i zbatuar, në lidhje me kontrollimin e personave në kufirin doganor te kontrolli i bagazhit, mallrave dhe mjeteve të transportit gjatë importimit, eksportimit dhe në tranzit.

FORMALITETET DOGANORE PARA DORËZIMIT TË DEKLARATËS SË mallrave

- Do të thotë të gjitha veprimet që do të bëhen nga personi përkatës dhe Doganat nga koha kur mallrat paraqiten në territorin doganor deri sa të vendosen nën procedura doganore.

FORMALITETET DOGANORE TË APLIKUESHME NË MJETET E TRANSPORTIT PËR SHFRYTËZIM KOMERCIAL

- Do të thotë të gjitha veprimet që mrrren nga personi përkatës dhe nga Doganat në lidhje me transportin për përdorim komercial që vjen apo niset nga territori doganor, dhe gjatë qëndrimit të tyre aty.

GARANIONI

- Një person fizik ose juridik (në përgjithësi një bankë apo kompani sigurimi) që pranon përgjegjësinë në formën e duhur ligjore për pasojat financiare të mospërbushjes së obligimeve të tjetrit ndaj Doganave.

GARANIONI

- Ndërmarrje me të cilën garantuesi merr obligime ndaj administratës doganore.

GARANIONI BANKAR

- Garancion zhdëmtimi apo performancë garantuese me të cilën banka zotohet që do të paguajë një shumë të caktuar nëse pala e tretë dështon në pagesë, apo nëse ndodhë ndonjë formë tjetër mospagese në afat. Një formë e shfrytëzimit është kur banka dëshiron që bartësi të lirojë ngarkesën të cilën e ka financuar, por kur fatura origjinale e ngarkesës nuk është ende e gatshme për të iu dorëzuar bartësit.

GARANIONI DOGANOR “OBLIGACIONI”

- Veprim ligjor me të cilin personi e obligon veten ndaj Doganave për të bërë apo për të mos bërë ndonjë veprim specifik.

GARANIONI I SIGURIMIT

- Letër-zhdëmtim me të cilën kompania e sigurimit zotohet të paguaj një shumë të caktuar nëse dështon pala e tretë, apo nëse ndonjë formë tjetër e mosplotësimit të zotimeve ndodh.

GJOBA

- Një sanksion, shpesh monetar i vënë për shkak të dështimit për t’iu përmbajtur një ligji apo rregulloreje.

HAPËSIRA DYTËSORE

- Hapësira ku automjetet/udhëtarët dërgohen nga Dogana për kontrollim më të plotë.

HAPËSIRA E TREGTISË SË LIRË

- Entitet i formuar nga territoret doganore të një bashkimi të dy a më shumë shtetesh dhe që ka këto veçori:

Eliminimi i detyrimeve doganore për prodhimet me origjinë nga cilido vend i kësaj hapësire

Secili shtet ruan tarifatat dhe ligjet e tij doganore

Secili shtet i hapësirës ruan autonominë në çështjet e Doganave dhe politikave ekonomike

Tregtia bazohet në aplikimin e rregullave të origjinës, për të marrë parasysh tarifatat e ndryshme doganore dhe parandalimin e devijimit të tregtisë

Eliminimi i rregulloreve restriktive të tregtisë brenda hapësirës së tregtisë së lire.

HONORARET

- Pagesë e bërë për të drejtën për shfrytëzim, prodhim, apo shitje të një produkti të caktuar. Honoraret zakonisht llogariten si përqindje e njësisë të prodhuara, të shpërndara apo të shitura.

HYRJA NË, DHE BASTISJA E MJETEVE TË TRANSPORTIT

- Operacionet kur mjetet e transportit vizitohen nga Doganat për:

a) mbledhje të informatave nga personi përgjegjës për mjetet e transportit dhe për kontroll të dokumentacionit komercial dhe të transportit apo dokumenteve tjera në lidhje me mjetet e transportit, ngarkesës, depove, ekuipazhit apo pasagjerëve, dhe

b) inspektim, kontroll dhe bastisje të mjeteve të transportit.

HYRJE KONSUMI

- Hyrje formale që lejon lëvizjen e menjëhershme të mallit në ekonominë e një vendi.

HYRJE PËR KONSUMIM VENDOR

- Përfshinë hyrjen nën çfarëdo nëntitulli apo numri klasifikues në Tarifën Doganore për çfarëdolloj përdorimi apo qëllimi brenda Kosovës.

I OBLIGUAR

- Do të thotë, i siguruar me anë të obligacionit ndaj Doganave, në pritje të performancës apo plotësimit të veprimeve specifike sipas obligimeve të kontratës, angazhimit apo marrëveshjes, të zbatueshme si dënim ligjor.

IMPORTI

- Akti i sjelljes, hyrjes apo shkaktimit të sjelljes së çfardo malli brenda territorit doganor të Kosovë.

IMPORTIM KOMERCIAL

- Importimi i mallit në ekonominë e Kosovës për diçka tjetër e jo për përdorim personal të një individi.

IMPORTUESI

- Person i cili sjell mallra, ose shkakton sjelljen e mallrave nga një vend i hauj në territorin e Kosovës dhe i cili në kohën e eksportimit:

Është pronar i mallrave që importohen

Mban rrezikun për mallrat e importuara

Përfaqëson apo vepron si të ishte ai eksportuesi apo pronari i mallrave të importuara

Faktikisht sjell mallra brenda Kosovës

Është i interesuar si përfitues për cilindo mall të importuar.

INSPEKTIMI

- Kontroll i hollësishëm i bagazheve, udhëtarëve dhe ngarkesave në kohën e hyrjes në Kosovë. Inspektimi në formën e tij më të thjeshtë është një verifikim i sasisë dhe/ose peshës dhe vlerës së mallrave të tregtuara, ose në qoftë se kjo ndodh në një kufi verifikimi mund të përbëhet nga shqyrtimi i dokumentacionit të eksportit/importit me një kontroll vizual të mallrave në bazë të gjykimit profesional.

INSTITUTI KOMBËTAR I METROLOGJISË

- Instituti Kombëtar i Metrologjisë (IKM) është institut i caktuar me vendim kombëtar për të zhvilluar dhe ruajtur standardet kombëtare të matjes për një ose më shumë sasi

INSTRUMENTET MONETARE

- Valuta, çeqet e udhëtarëve, apo instrumente tjera të negociueshme siç janë çeqet të cilat janë në formë mbajtësi, p.sh. të negociueshme nga mbajtësi.

JO-REZIDENT

- Çdo person që arrin në vend e i cili nuk është banor i atij vendi apo i cili, edhe pse banor ligjor i atij vendi, nuk kthehet për të banuar apo për të vazhduar të banojë (p.sh. vazhdon udhëtimin jashtë vendit).

KABOTAZH

- Transport i mallrave ose pasagjerëve në mes të pikave në të njejtin shtet përmes lundrës ose fluturakes së regjistruar në një vend tjetër. Shumë shtete nuk e lejojnë kabotazhin.

KALIBRIMI

- Kalibrimi i referohet një procesi të verifikimit se një instrument është brenda saktësisë së tij të caktuar. Kjo zakonisht arrihet përmes një krahasimi formal me një standard të matjes që është i gjurmueshëm me standardet kombëtare ose ndërkombëtare.

KANAL I DYFISHTË

- Sistem i thjeshtëzuar doganor i kontrollit që lejon udhëtarët në arritje të bëjnë deklarin doganor vullnetar duke zgjedhur mes dy llojeve të kanaleve. Njëri i identifikuar me simbole të gjelbërta, është për shfrytëzim të udhëtarëve që bartin mallra në sasi që nuk e tejkalon sasinë e lejuar që është e liruar nga dogana dhe të cilat nuk janë çështje për ndalim apo kufizim të importit. Tjetri i identifikuar me simbole të kuqe është për udhëtarët tjerë.

KAPITEN

- Në lidhje me anijen, personi (përveq timonierit) përgjegjës për anijen.

KARNET

- Dokument ndërkombëtar i transportit që mund të përdoret për importim të përkohshëm, pa doganë të mallrave të caktuara në një vend së bashku me dokumentet e zakonshme të doganës apo depozitimit që kërkohet në para të gatshme. Karneti shërben si garancion për pagesën e detyrimeve doganore që janë në rrezik në procedura tranzitore. Karneti gjithashtu garanton pajtueshmëri me kërkesat doganore. Për më shumë mund të përdoret si dokument eksporti.

KARNETI ATA

- Një dokument ndërkombëtar doganor i cili lëshohet sipas kushteve të Konventës ATA dhe Konventës së Stambollit, përmban garanci të vlefshme ndërkombëtare dhe mund të përdoret në vend të dokumenteve kombëtare doganore dhe si siguri për detyrimet dhe tatimet e importit, për të mbuluar

pranimin e përkohshëm të mallrave dhe tranzitimin e mallrave kur është e përshtatshme. Mund të pranohet për të kontrolluar eksportimin e përkohshëm dhe ri-importimin e mallrave, por në këtë rast garancia ndërkombëtare nuk zbatohet.

KARNETI CPD

- Dokument doganor ndërkombëtar që inkorporon një garanci valide ndërkombëtare dhe mund të përdoret, së bashku me dokumentet doganore vendore si siguri për detyrimet dhe tatimet e importit, për të mbuluar çmimin e hyrjes për mjetet e transportit, dhe ku është e përshtatshme, tranzitin e mjeteve të transportit. Mund të pranohet për kontrollim të eksportimit të përkohshëm dhe ri-importimit të mjeteve të transportit, por në rast të tillë garancia ndërkombëtare nuk aplikohet.

KLASIFIKIMI

- Kodi në formë numri i një sendi nga nomenklatura e sistemit të harmonizuar (në Kosovë, TARIK) që legalisht përshkruan mallin që importohet për të ardhur deri te rata e duhur e detyrimeve doganore dhe/apo tatimeve dhe për qëllime statistikore.

KLASIFIKIMI TARIFOR I mallrave

- Përcaktimi i nën-titullit tarifor dhe emërimit të koduar të numrit të artikullit në një nomenklaturë tarifore sipas së cilës duhet të klasifikohen mallrat e veçanta.

KLAUZOLË E ARBITRAZHIT

- Klauzolë në kontratën e shitjes që kërkon nga palët të zgjidhin të gjitha kontestet me arbitrazh (p.sh. me vendim të arbitrit si palë e tretë) e jo në gjykata.

KODI DOGANOR

- Dispozitat ligjore dhe rregulluese që kanë të bëjnë me importimin dhe eksportimin e mallrave, administrimi dhe zbatimi i të cilave është përgjegjësi specifike e Doganave, dhe çfarëdo rregullore e bërë nga Doganat në bazë të fuqive të tyre të parashikuara me statut.

- Kjo përfshin dispozitat ligjore lidhur me importimin, eksportimin, lëvizjen apo deponimin e mallrave, administrimi dhe zbatimi i të cilave specifikisht i është lënë në përgjegjësi Doganave, si dhe rregullat e bëra nga Doganat sipas fuqive të tyre të parashikuara me statut

KOMISION BLERJEJE

- Tarifë që i paguhet agjentit nga importuesi për përfaqësimin e importuesit në blerjen e mallrave të importuara. Shërbimet e kryera nga agjenti blerës mund të përfshijnë blerjen, transferimin, kontrollin

e kualitetit dhe shërbime të ngjashme. Komisionet e blerjes nuk duhet t'i shtohet çmimit të paguar apo të pagueshëm gjatë përcaktimit të vlerës doganore

KOMISIONI I SHITJES

- Çdo komision që i paguhet agjentit të shitësit, i cili është i lidhur apo i kontrolluar nga, apo punon për apo në emër të, prodhuesit apo shitësit.

KOMPENZIM I BARASVLERSHËM

- Sistemi lejon, nën procedura të caktuara doganore, eksportimin apo importimin e mallrave identike sipas llojit, përshkrimit, cilësisë dhe karakteristikave teknike me ato të importuara apo eksportuara paraprakisht.

KONFISKIM

- Akti i transferimit të kontrollit dhe pronësisë së një malli nga importuesi te Doganat për shkak të shkeljeve të caktuara të ligjit.

KONFISKIM I KONSTATUAR

- Ndëshkimi i kryer nga ana e zyrtarit doganor në lidhje me mallrat, të cilat janë përcaktuar se janë në kundërshtim me ligjin doganor dhe mallrat të cilat do të ishin subjekt i konfiskimit përveç nëse mallrat nuk gjinden apo nëse një konfiskim i tillë është jo praktik.

KONFISKIMI

- Marrja në posedim dhe /apo kontroll fizik e mallrave apo artikujve tjerë për të cilët besohet se janë importuar apo në ndonjë mënyrë tjetër shfrytëzohen në kundërshtim me ligjin.

KONTEINER

Një lloj pajisje transporti që:

- i) Përbën një ndarje të mbyllur plotësisht ose pjesërisht për të mbajtur mallra;
- ii) Ka karakter të përhershëm dhe është rezistent në atë masë që të mund të përdoret në mënyrë të përsëritur,
- iii) Është projektuar në mënyrë të tillë që lehtëson transportin e mallave, me një ose disa mënyrash transporti, pa pasur nevojë për ngarkim-shkarkime të ndërmjetme,

iv) Është projektuar për t'u manovruar lehtësisht, posacerisht gjatë transbordimit nga një lloj transporti në një tjetër,

v) Është projektuar në mënyrë të tillë që mbushet dhe zbrazet lehtësisht

vi) Me një vëllim të brendshëm prej 1m³ e më shumë

Termi " konteiner " përfshin aksesorë dhe pajisje të kontenierit të përshtatshme për llojin në fjalë, me kusht që të transportohen bashkë me kontenierin. Ky term nuk përfshinë automjetet, aksesorët ose pjesë këmbimi të tyre, ambalazhe dhe paleta. "Trupat e çmontueshëm" duhet të konsiderohen si konteniere.

KONTRABANDË

- Mall i cili nuk është importuar apo eksportuar ligjërisht; mall i kontrabanduar, substanca të kontrolluara apo mallra, tregtimi ndërkombëtar i të cilave është i ndaluar.

KONTROLLE NGA DOGANA

- Masat e aplikuara për të siguruar përputhshmëri me Ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës të cilat Doganat janë përgjegjëse për t'i zbatuar sa i përket importimit dhe eksportimit të mallrave.

KONTROLLAT E EKSPORTIT

- Kontrollat e eksportit janë ligje dhe rregullore që kontrollojnë kushtet nën të cilat mallrat, teknologjia dhe informatat e caktuara mund të eksportohen. Doganat zbatojnë ligjet e kontrollit të eksportit.

KONTROLLI I BAZUAR NË AUDITIM

- Masat me të cilat dogana sigurohet për saktësinë dhe autencitetin e deklaratave përmes kontrollit të librave relevante, regjistrimeve, sistemeve afariste dhe të dhënave komerciale që mbahen nga personat e përkatës.

KONTROLLIMI I AUTOMJETEVE

- Një kontroll sipërfaqësor i veturave mund të bëhet nga Dogana në linjën e parë të inspektimit, me një kontroll më të plotë që mund të kryhet nëse automjeti dërgohet në vijën e dytë të inspektimit.

KONTROLLIMI I MALLRAVE

- Inspektimi fizik i mallrave nga Doganat për ta bindur veten se natyra, origjina, gjendja, sasia dhe vlera e mallrave janë në përputhje me të dhënat e paraqitura në Deklaratën e mallrave.

KONTROLLIMI I PERSONAVE APO KONTROLLIMET PERSONALE

- Kontrollim i detyruar i kryer në bazë të informatave apo faktorëve tjerë që ngjallin dyshime se kontrabandimi apo malli subjekt i ligjeve doganore është i fshehur nga personi.

KONVENTA ATA

- Shprehje që zakonisht përdoret për t'iu referuar Konventës së Doganave për ATA Carnet për hyrje të përkohshme të mallrave (Konventa ATA).

KONVENTA E KYOTO-S (E NDRYSHUAR)

- Konventa ndërkombëtare mbi thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave doganore e miratuar nga Këshilli për Bashkëpunim Doganor në Kyoto me 1973, e amendamentuar në Qershor 2000, dhe e hyrë në fuqi me 3 Shkurt 2006.

KONVENTA E NAJROBI-T

- Term që zakonisht përdoret për t'iu referuar Konventës ndërkombëtare mbi Asistencën Administrative për Parandalimin, Hetimin dhe Shtypjen e Kundërvajtjeve Doganore, e miratuar nga Këshilli për Bashkëpunim Doganor në Najrobi më 1977.

KONVENTA E STAMBOLLIT

- Term që zakonisht përdoret për t'iu referuar Konventës për Hyrje të Përkohshme, e miratuar nga Këshilli Bashkëpunues i Doganave në Stamboll më 1990.

KRITERI SUBSTANCIAL I TRANSFORMIMIT

- Kriteri sipas të cilit është përcaktuar origjina duke konsideruar si vend të origjinës vendin në të cilin është kryer prodhimi apo përpunimi i fundit substancial, që ka mjaftuar për t'i dhënë mallit karakterin e tij thelbësor.

KUFINJTË E PORTIT

- Kufinj të gjeografik të një porti hyrës.

KUFIRI

- Vijë kufitare në kufirin e një vendi apo territor me një tjetër vend apo territor

KUFIRI DOGANOR

- Kufiri i territorit kombëtar të një vendi.

KUFIZIMI I mallrave

- Një kërkesë ligjore nga ligji për dorëzim dhe aprovim të një aplikacioni apo ndonjë dokumenti tjetër (përveç për qëllime Doganore) si një parakusht për importim apo eksportim.

KUNDËRTREGTI

- Kundërtregtia është këmbimi i mallrave dhe shërbimeve me mallra ose shërbime tjera dhe jo me para. Është metodë e financimit të transaksioneve kur monedhat nuk janë në dispozicion, ose janë në dispozicion në shuma shumë të kufizuara. Katër lloje të zakonshme të kundërtregtisë janë: (1) shkëmbimi; (2) kundër blerja; (3) blerja prapa (buy back); dhe (4) ofseti apo kompensimi.

KUNDËRVAJTJE DOGANORE

- Çfarëdo shkelje, apo tentim shkelje e Kodit Doganor.

KUOTA E NORMËS TARIFORE

- Çdo vlerë apo sasi e paracaktuar, e autorizuar për importim apo eksportim të mallrave të caktuar, me zbritjen e detyrimeve doganore, dhe përtej të cilave çdo sasi shtesë e këtyre mallrave mund të importohen apo eksportohen duke paguar doganore normale (ose më të lartë).

KUOTA E SASISE

- Çdo sasi e para-caktuar, e autorizuar për importimin apo eksportimin e mallrave të caktuara, gjatë një periudhe të caktuar, përtej së cilës asnjë sasi shtesë e këtyre mallrave nuk mund të importohet apo eksportohet.

KUOTIM

- Ofertë për të shitur mallra me çmim të deklaruar dhe sipas kushteve të theksuara.

KURSI I JASHTËM I KËMBIMIT

- Kursi apo çmimi i valutës së një vendi në raport me valutën e një vendi tjetër.

KUSHTET E SHITJES

- Kushtet për të cilat pajtohen blerësi dhe shitësi në lidhje me shitjen dhe transportin e mallrave p.sh. FOB, CIF.

LEHTËSIMI (i tregtisë)

- Programe dhe procedura të dizajnuara për të nxitur tregtinë ndërkombëtare me mallra

LEJA PËR IMPORT/EKSPORT (APO LICENCA PËR IMPORT/EKSPORT)

- Autorizim i lëshuar nga autoritetet kompetente për importim apo eksportim të mallrave që janë subjekt i kufizimit.

LEJE

- Autorizim ligjor që lejon një veprimtari të caktuar; në procedurë doganore, një dokument miratimi që përdoret për efekt të lirimimit apo lëvizjes së mallit.

LEJE PËR PËRDORIM BRENDA VENDIT

- Procedurë doganore që lejon mallrat e importuara të mbeten përherë në territorin doganor. Kjo procedure implicon pagesën e detyrimeve dhe taksave të pagueshme të importit dhe kompletimin e të gjitha formaliteteve doganore.

LETËRKREDI E PAREVOKUESHME

- Një letërkredi, që nuk mund të ndryshohet apo anulohet pa pajtim paraprak të të gjitha palëve në kredi.

LETRA KREDIT (LC)

- Dokument e lëshuar nga banka që e autorizon bartësin të tërheq shumën e deklaruar të parave nga banka lëshuese, degët e saj, apo bankat ose agjencionet e tjera të lidhura, pasi që ai/ajo të pajtohet me kushtet e letërkredisë.

LICENCË EKSPORTI

- Leje apo aprovim tjetër që kërkohet për t'u marrë me eksport të mallrave dhe sasive të caktuara në destinacione specifike.

LICENCIMI I DETYRUESHËM

- Për patentat: kur autoritetet licencojnë kompanitë ose individëve të tjerë se pronari i patentit për të përdorur të drejtat e patentës – për të bërë, të përdorur, të shesë ose të importojë një produkt nën patentë (dmth një produkt të patentuar apo një produkt të bërë nga një procesi i patentuar) – pa lejen e pronarit të patentës. Kjo parashihet me Marrëveshjen TRIPS (të pronësisë intelektuale) të OBT-së, pasi që procedurat dhe kushtet e caktuara të janë plotësuar.

LIRIM I PJESSHËM

- Lirim nga pagesa e një pjese të shumës totale të detyrimeve dhe tatimeve të importit, të cilat përndryshe do të ishin të pagueshme.

LIRIMI

- Veprim nga Doganat që lejon mallrat e nënshtruara zhdoganimi të vendosen në dispozicion të personave përkatës.

LIRUAR ME KUSHT

- Mall i liruar nga detyrimet nën kushte të caktuara, apo derisa të përmbushen kushtet e caktuara.

LISTA E NGARKESËS AJRORE

- Kontrata, dokumenti që përdoret për transportin ajror i cili përfshin kushtet, kufizimet mbi përgjegjësinë, udhëzimet mbi dërgesën, përshkrimi i mallit, dhe pagesat e zbatueshme për transport. Është përgjithësisht ngjashëm me faturën e panegociueshme të ngarkesës dhe përdoret për qëllime të ngjashme.

LISTA E PAKETIMIT

- Përshkrim i detajizuar me shkrim i artikujve se çfarë artikujsh janë të paketuara në pako.

LISTË E ITINERARIT HEKURUDHOR apo NJOFTIM KËSHILLUES HEKURUDHOR

- Dokument që përdoret për të kontrolluar transportimin e dërgesave të mallit përmes hekurudhës. Është e ngjashme në përmbajtje me faturën e ngarkesës së brendshme, me tarifën dhe pagesat tjera, dhe me itinerarin.

LISTË E NGARKESËS

- Listë e ngarkesës që është duke u transportuar ose magazinuar; listë e mallit që përbën ngarkesën që bartet me mjete transporti apo që është në njësinë e transportit. Lista e ngarkesës që jep veçoritë komerciale të mallrave, siç janë numrat e dokumenteve të transportit, dërguesit, shenjat dhe numrat, numrin dhe llojin e pakove, përshkrimin dhe sasinë e mallrave. Mund të përdoret edhe si deklaratë e ngarkesës.

LLOGARITJA

a) Vlerësimi apo përcaktimi i vlerës së mallrave;

b) Akti i ndarjes së shumave për pagesë, ose

c) Një shumë e vlerësuar apo e ngarkuar, për shembull: detyrimet , tatimet ose provizioneve tjera.

MAGAZINA

- Çdo objekt në pronësi të Qeverisë së Kosovës ose të një subjekti privat të themeluar për ose të autorizuar për të magazinuar mallrat e importit apo eksportit për arsye sigurie, që janë në pritje të pagesave të detyrimeve dhe tatimeve të duhura, nëse ka, ose për të siguruar përputhshmëri me dispozitat e çfarëdo ligji që ka të bëjë me ato mallra, në pritje të lirimit të mallit nga kontrolli doganor nga objektet e tilla nën një procedurë doganore.

MAGAZINA DOGANORE

- Do të thotë lokalet që sigurohen dhe operohen nga Shërbimi Doganor për të magazinuar mallrat e importuara apo eksportuara që janë braktisur apo konfiskuar, e që janë në pritje të dhënies në ankand ose për t'u asgjesuar.

MAGAZINË NEN GARANCION (OBLIGACION)

- Magazine private e miratuar që përdoret për magazinimin e mallrave që janë në pritje të lirimit nga hapësirat e tilla në bazë të një procedure doganore të deklaruar, deri në kohën kur detyrimet dhe tatimet, nëse ka, paguhen dhe mallrat lirohen në mënyrë të rregullt nga kontrolli doganor. Obligacionet duhet të postohen nga pronari i magazines dhe/ose nga importuesi për të kompensuar Qeverinë nëse mallrat lirohen në mënyrë jo të rregullt.

MALL I DORËZUAR (KONSIGNACION)

- Mall i transferuar te një importues, pa pagesë, për t'u shitur me ndarje të profitit apo me përqindje.

MALL QË NUK DEKLAROHET (PRETENDOHET)

- Mallra, që kanë hyrë ose nuk kanë hyrë, që kanë mbetur nën ruajtje doganore për një periudhë që tejkalon afatet ligjore.

mallraT E KTHYERA

- Prodhimet e bëra në Kosovë dhe të cilat kthehen pasi që janë eksportuar. Këto produkte janë të liruara nga dogana nëse nuk janë avancuar në vlerë ose përmirësuar në gjendje me ndonjë proces përpunimi apo masa tjera derisa kanë qenë jashtë.

MALLRAT E KUIVALENTE

- Mallra identike në përshkrim, cilësi dhe karakteristika teknike me ato të importuara apo eksportuara për përpunim të brndshëm apo të jashtëm apo për procedure rikthimi.

MALLI I KUFIZUAR

- Mall i importuar në Kosovë për të cilin kërkohet licencë e veçantë, leje, etj., para se të pranohet për tregti.

MALLRA FALSE/SHKELËSE

- Mallra që inkorporojnë pronën intelektuale (patentat, objektet me të drejtë autori dhe të drejta fqinje, prona industrial, si dhe marka e fabrikës, emrat e vendeve të origjinës së mallit, dhe objektet tjera të pronës intelektuale në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës), nëse prodhimi i mallrave të tilla, transporti i tyre përtej kufive doganor apo veprimet tjera me mallra nën kontroll doganor rezultojnë me shkelje të të drejtave të mbajtësit të të drejtave që janë të mbrojtura me legjislacionin e Republikës së Kosovës.

MALLRA TË KOSOVËS

- Nënkupton mallra të përfituara tërësisht në Kosovë sipas kushteve të përcaktuara me nenin 27 të Kodit Doganor dhe që nuk kanë në përbërjen e tyre mallra të importuara nga vendet apo territoret jashtë Kosovës. Mallrat e përfituara nga mallrat e vendosura nën regjimin e pezullimit nuk do të përcaktohen si mallra Kosovare.

MALLRAT

- Një artikull që ka përdorim ekonomik – produkte të prekshme dhe materiale si depotë, bagazhin, kafshët, transportet, valutat etj.

MALLRAT E EKSPORTUARA ME NJOFTIM TË QËLLIMIT PËR TU KTHYER

- mallrat e eksportuara me njoftim të qëllimit për tu kthyer do të thotë mallrat e specifikuar nga deklaruesi se ka qëllim që t'i ri-importojë, për të cilat masat identifikuese mund të mirren nga Doganat për të lehtësuar ri-importimin në shtetin e njëjtë.

MALLRAT E NDALUARA

- Mallra, importimi apo eksportimi i të cilave është i ndaluar me ligj.

MALLRAT NË QARKULLIM TË LIRË

- Mallrat që mund të shiten pa kufizime doganore.

MALLRAT PA DOGANË NË DYQANET PA DOGANË

- Mallrat e importuara pa detyrime dhe tatime doganore, dhe mallrat vendore të liruara nga tatimet e brendshme.

MANIFESTI

- Instrument i shkruar që përmban llogari të vërtetë dhe të saktë të mallit të importuar. Duhet të përmbajë një listë të pakove apo sendeve të ndara të ngarkesës me shenjat e tyre dalluese apo numrat.

MARKA TREGTARE

- Emër i veçantë, moto, embleme, simbol apo pajisje tjetër që identifikon një produkt, i regjistruar zyrtarisht dhe e kufizuar ligjërisht nga pronari apo prodhuesi për t'i identifikuar mallrat e tij në treg.

MARRËSI I NGARKESËS

- Personi apo firma së cilës i destinohet malli.

MARRËVESHJA MBI BTT

- Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë mbi Barrierat Teknike për Tregti (BTT) — synon reduktimin e pengesave për tregti që rezultojnë nga dallimet në mes të rregullave, standardeve kombëtare dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit.

MARRËVESHJA PËR TREGTI TË LIRË

- Marrëveshje që ofron lirim nga doganat apo tarifa të reduktuara për mallin nga vendet specifike me qëllim të stimulimit të tregtisë.

MARRËVESHJE E NJOHJES SË NDËRSJELLË

- Marrëveshjet e njohjes së ndërsjellë (MNN) janë marrëveshje formale ndërmjet palëve ku ato bien dakord të njohin rezultatet e testimit të njërit-tjetrit, inspektimit, çertifikimit, ose akreditimit. MNN-të janë një hap i rëndësishëm drejt reduktimit të vlerësimit të shumëfishtë të konformitetit të cilit produktet, shërbimet, sistemet, proceset dhe materialet mund të kenë nevojë t'i nënshtrohen, sidomos kur tregtohen përtej kufijve.

MARRËVESHJE KOMPROMISI PËR SHKELJE DOGANORE

- Një marrëveshje me të cilën autoritetet doganore, me fuqinë që iu është dhënë, pajtohen të heqin dorë nga procedurat në lidhje me shkeljen doganore që është subjekt i pajtueshmërisë, me kushtet e caktuara, nga personat e implikuar në shkelje.

MARRËVESHJET PËR PARTNERITET EKONOMIK (MPE)

- Marrëveshjet për Partneritet Ekonomik (MPA-të) janë krijuar për promovimin e tregëtisë në mes të Bashkimit Evropian dhe Afrikës, Karaibeve dhe Grupit të Shteteve të Pacifikut.

MASA

- Matja me qëllim të caktimit të vëllimit, përmbajtjes së dëshmisë, trashësisë etj., të mallrave të caktuara.

MASHTRIM

- Mashtrim i qëllimshëm. Tentim i qëllimshëm për të mashtruar duke zhdukur apo shtrembëruar faktet në çfarëdo çështje materiale.

MASHTRIM KOMERCIAL

- Çfarëdo kundërvajtje në kundërshtim me dispozitat apo rregulloret, për zbatimin e të cilave është përgjegjëse Dogana, e kryer me qëllim të;

- Shmangies, apo tentim shmangies, së pagesës së detyrimeve/taksave/tatimeve në qarkullimin mallit komercial; dhe/ose për pranim, apo tentim pranimi, të çfarëdo rikthimi parash, subvencioni apo shpërblimi tjetër në të cilin nuk ka të drejtë; dhe /ose për marrjen, apo tentim marrjen, e përparësisë së paligjshme komerciale që është e dëmshme për parimet dhe praktikat konkurrencës legjitime në biznesit.

MASHTRIM PËRMES TRANSFERIMIT

- Mashtrim i kryer gjatë lëvizjes së mallit përmes një vendi tjetër përgjatë rrugës drejt vendit të importimit nga vendi i eksportimit. Mashtrimi përmes transferimit përdoret zakonisht për të kontrabanduar mallra, për të shmangur kuotat kufizuese, për përfitim të normave tatimore më të favorshme, apo për të fshehur origjinën e mallrave të ndaluara

MASHTRIM TREGTAR

- Çdo shkelje e dispozitave ligjore ose rregulloreve, përgjegjëse për zbatimin e të cilave është Dogana, të kryera me qëllim të:

shmangies apo tentim shmangjeje së pagesës së detyrimeve/taksave/tatimeve për lëvizjen e mallrave komerciale;

dhe/ose

shmangies apo tentim shmangjeje ndaj ndalesave apo kufizimeve të zbatueshme për mallrat tregtare;

dhe/ose

marrjes apo tentim marrjes së avantazheve të paligjshme tregtare të dëmshme për parimet dhe praktikën e konkurrencës legjitime të bizneseve.

MASHTRIMI DOGANOR

- Cilido veprim me të cilin personi gënjen, apo tenton të gënjejë, Doganat dhe me këtë shmang, apo tenton të shmang, tërësisht apo pjesërisht, pagesën e detyrimeve dhe tatimeve të importit apo eksportit apo zbatimin e ndalesave apo kufizimit të vendosura me dispozitat rregulluese të zbatuara apo administruara nga administratat doganore dhe nëse merr, ose provon të marrë, çfarëdo përfitimi në kundërshtim me ato dispozita, dhe me këtë kryen një kundërvajtje doganore.

MBIKQYRJE DOGANORE

- Çfarëdo veprimi apo gjëje që kërkohet të bëhet nën mbikqyrje të zyrtarëve doganorë, që mund të vjen si verifikim i vazhdueshëm apo i rastit. Rregullat mund të kërkojnë këtë, apo në mungesë të rregullave për raste të veçanta, ashtu siç kërkon zyrtari doganor.

METROLOGJIA

- Metrologjia është shkenca e matjeve. Asnjë testim nuk do të ishte i mundur përveq nëse karakteristikat e produktit apo shërbimit në fjalë të mund të mateshin duke i krahasuar ato me një reference fizike apo kimike me vlerë të njohur. Prandaj, metodat adekuate për matjen e përmbajtjes së produkteve dhe shërbimeve janë thelbësore për procesin e vlerësimit të cilësisë.

METROLOGJIA LIGJORE

- Tërësia e procedurave ligjore, administrative dhe teknike të vendosura nga, ose duke iu referuar autoriteteve publike, dhe që zbatohen në emër të tyre, për të specifikuar dhe siguruar, në një mënyrë të kodifikuar ose kontraktuale, cilësinë e duhur dhe besueshmërinë e matjeve në lidhje me kontrollet zyrtare, tregtinë, shëndetin, sigurinë dhe mjedisin.

MJET TRANSPORTI

- Çdo automjet, fluturake, lundër apo çfarëdo shpikje tjetër që përdoret për transport personash apo mallrash.

MJETET E TRANSPORTIT PËR SHFRYTËZIM KOMERCIAL

- Çdo lundër (dike përfshirë lundrat e sheshta apo varkat, qofshin ose jo anije, dhe motoskaftet), mjetet lundruese, fluturaket, automjetet rrugore (përfshirë rimorkiot, gjysëm-rimorkiot, dhe kombinimet e automjeteve) ose binarë që shfrytëzohen për transport të personave me pagesë apo për transport industrial apo komercial të mallrave, qoftë me pagesë apo pa pagesë.

MJETET E TRANSPORTIT PËR SHFRYTËZIM PRIVAT

- Automjetet rrugore motorike (duke përfshirë motoçikletat) dhe rimorkiot, barkat dhe fluturaket të cilat janë ekskluzivisht për përdorim privat nga personi e jo për transport të personave me pagesë apo për transport industrial apo komercial të mallrave me ose pa pagesë.

MJETET KOMERCIALE TË TRANSPORTIT

- Çfarëdo lundre (përfshirë lundrat e sheshta dhe barkat, qofshin ose jo anije, dhe motoskaftet), automjetet, fluturaket, automjetet rrugore (përfshirë rimorkiot, gjysëm-rimorkiot dhe automjetet e kombinuara, ose binarë që shfrytëzohen për transport të personave me pagesë apo për transport industrial apo komercial të mallrave, qoftë me pagesë apo pa pagesë.

MONEDHA

- Bankënotat dhe monedhat që janë mjete aktuale këmbimi apo tender ligjor në një vend.

MOSTRA PA VLERË KOMERCIALE

- Artikuj të cilët nga Dogana konsiderohen të jenë me vlerë të papërfillshme dhe të cilët do të përdoren vetëm për të kërkuar porosi të mallrave të llojit që ato i përfaqësojnë

MOSTRAT

- Artikuj të cilët janë përfaqësues të një kategorie të mallrave tashmë të prodhuara apo janë shembuj të mallrave prodhimi i të cilave është parashikuar; termi nuk përfshin artikujt identik të sjellur nga individ i njëjtë, ose që i dërgohen një marrësi të vetëm, në sasi të tillë, që marrë në tërësi, ato më nuk përbëjnë mostra sipas përdorimit të zakonshëm tregtar.

MUNGESAT

- Ligji mund të parashehë që në qoftë se një mangësi është gjetur në sasi, peshë apo masë gjatë kontrollit të cilësdo pakoje, do të bëhet një raport dhe do të bëhet kompensim për mangësinë.

NDALIMI

- Akti i marrjes së mallit të importuar në pesdim nga Doganat, në pritje të përcaktimit të lejueshmërisë apo përmbushjes së kërkesave doganore.

NDIHMESAT

- Për qëllime doganore, “ndihmesat” janë ndihmë e dhënë shitësit nga blerësi. Ato përfshijnë këto në vijim nëse janë furnizuar direkt apo indirekt dhe falas apo me çmim të ulur nga blerësi i mallit me qëllim të përdorimit për prodhim apo shitjes për eksport në vendin importues të mallit. Llojet e ndihmesave:

1) materialet, përbërësit, pjesët dhe gjërat e ngjashme të inkorporuara në prodhimin e mallit të importuar, 2) Veglat, shtypëset, kallëpët dhe gjërat e ngjashme që përdoren për prodhimin e mallit të importuar, 3) malli i konsumuar në prodhimin e mallit të importuar, dhe 4) përpunimi, zhvillimi, puna artistike, dizajnimi, planet dhe skicat që bëhen në vend të ndryshëm nga vendi i importimit dhe që janë të domosdoshme për prodhimin e mallit të importuar.

NË DEPO DOGANORE

- Term që përdoret për të përshkruar mallin për të cilin detyrimet dhe tatimet nuk janë paguar dhe i cili është nën një formë l deponuar në doganë për dëmtime likuiditeti nëse nuk përmbushen kushtet e deponimit doganor. Mund t’i referohet edhe mallit i cili transportohet nën obligimin doganor me transportues të zakonshëm, mall në depo doganore apo lundër dhe furnizimi dhe pajisje për fluturake.

NËN KUJDES TË DOGANAVE

- Mall nën kontroll (posedim fizik apo efektiv) të Doganave.

NGARKESA

- Të gjitha mallrat e bartura komerciale që ofrohen për të hyrë në Kosovë përveq bagazhit në posedim të pasagjerit që arrin. Hapësira e ngarkesave zakonisht mbahet e ndarë pasagjerët dhe bagazhi i tyre.

NGARKESA E BRAKTISUR

- Ngarkesë e importuar nga e cila importuesi ka hequr dorë vullnetarisht dhe e cila është mbajtur në Doganë për sistemim të duhur sipas ligjit.

NGARKESAT E MËDHA (REFUS)

- Mallrat siç janë: xehet, thëngjilli, gruri, vaji etj., të cilat normalisht transportohen të zgjidhura apo të pa paketuara. Në këtë model transporti, vetë anija është kontenier.

NGARKESAT SI NDIHMË

- Mallra të tilla si automjete dhe mjete të tjera të transportit, ushqimore, barna, veshje, batanije, tenda, shtëpi të parafabrikuara apo mallra tjera të nevojave primare, të dërguara si ndihmë për të prekurit nga fatkeqësitë natyrore ose katastrofa të ngjashme.

NGARKESË MALLRASH

- I gjithë malli, prodhimet apo artikujt që transportohen përmes hekurudhës, ajrit, rrugëve apo ujit, e që nuk janë bagazh, postë ekspres apo e rregullt.

NGARKIM

- Ngarkim, si te ngarkimi i mallrave.

NJËSIA E TRANSPORTIT

- Çdo mjet transportues i mallrave i përshtatshëm për përdorim në një operacion tranzit të Doganës apo nën vulën e Doganës

NOMENKLATURA TARIFORE

- Çdo klasifikim dhe sistem i kodimit i paraqitur nga administrata kombëtare, doganat apo unionet ekonomike për të përcaktuar mallrat apo grupet e mallrave të lidhura për qëllime të tarifimit doganor.

OBD

- Do të thotë Organizata Botërore e Doganave.

OBT

- Do të thotë Organizata Botërore e Tregtisë.

OPERACIONI I TRANZITIT DOGANOR

- Transporti i mallrave, nga një zyrë nisjeje te një zyrë destinacioni, nën procedurë të transitit doganor.

OPERATORI I DEPOSË

- Personi përgjegjës për depot e konteinerëve

OPERATORI I TERMINALIT

- Personi përgjegjës për terminalin e konteinerëve.

PAGESA E DREJTPËRDREJT

- Shembuj të pagesës së drejtpërdrejt përfshijnë pagesat e bëra me para të gatshme, çeqe, transfere elektronike, kartela krediti apo instrumente tjera siç është urdhërpagesa në letërkredi.

PAGESA E TERMINALIT

- Një pagesë e bërë për shërbimet e kryera në terminalet e transportit

PAGESA INDIREKTE

- Pagesa indirekte përfshin shlyerjen e pjesërishme apo të tërësishme të borxhit të shitësit nga ana e blerësit, apo rastin kur blerësi pranon zbritje në çmim të importit si mjet për shlyerjen e borxhit që ka shitësi ndaj tij.

PAGESA PËR LICENCË

- Pagesë që bëhet për të drejtën e shfrytëzimit, prodhimit apo shitjes së një produkti.

PAGESE PËR MOSNGARKIM NË AFAT

- Pagesë për tejkalimin e kohës së ngarkimit apo shkarkimit nga lundra që nuk shkaktohet nga operatori i lundrës, por si rezultat i veprimeve të transportuesit të mallrave.

PAGESË TRANSPORTI

- Kompenzimi që paguhet për transportimin e mallrave.

PAISJE SHTËPIAKE

- Mobilje, tepihë, libra, piktura, biblioteka, takëm, apo orendi tjera shtëpiake apo artikuj që kontribuojnë në rehati, volitshmëri apo dukje të shtëpisë.

PAJISJET PROFESIONALE

- Pajisjet e domosdoshme për ushtrimin e thirrjes, tregtisë apo profesionit të personit që hyn në vend për të ushtruar profesionin e tij apo saj në atë vend.

PAKETA

- Të gjithë artikujt dhe materialet e përdorura, ose që do të përdoren, në shtetin në të cilin janë importuar, për të paketuar, mbrojtur, mbushur apo ndarë mallrat, duke mos përfshirë materialet si: kashta, letra, leshi i qelqit, ashklat etj, kur importohen në masë. Konteinerët dhe paletat gjithashtu përjashtohen.

PAKO

- Do të thotë çfarëdo konteineri, mbështjellësi, mbulesë e brendshme apo e jashtme dhe përbërësit e saj, apo ndonjë deng a pjesë e vetme në rast të mallrave të pa-paketuara.

PAKOT POSTARE

- Artikujt e quajtur pako postare brenda kuptimit të Akteve të Unionit Postar Univerzal aktualisht në fuqi.

PALA E TRETË

- Çdo person i cili mirret direkt me Doganat, për dhe në emër të një personi tjetër, në lidhje me importimin, eksportimin, lëvizjen dhe magazinimin e mallrave.

PALETA

- Pajisje në të cilën mund të mblidhet një sasi e mallrave për të formuar një njësi ngarkese me qëllim të transportimit, apo të trajtimit apo grumbullimit me ndihmë të aparateve mekanike. Kjo pajisje është e përbërë nga dy kuverta të ndara nga bartësit apo nga një kuvertë e vetme e mbështetur me këmbë; lartësia e saj e përgjithshme është e reduktuar në minimum për të qenë kompatible për trajtim me kamionë pirunjerë apo kamionë për paleta; mund të ketë apo të mos ketë superstrukturë.

PARAQITJA E MALLRAVE PARA DOGANËS

- Akti i paraqitjes së mallrave para autoriteteve kompetente doganore, në vendin e destinuar apo të pranuar prej tyre, për kompletim të formaliteteve doganore.

PARIMET PËRGJITHËSISHT TË PRANUARA TË KONTABILITETIT (PPPK)

I referohet kornizës standarde të udhëzimeve për kontabilitet financiar që përdoret në Kosovë ose juridiksion tjetër. PPPK ka të bëjë me koncenusin e pranuar përgjithësisht apo përkrahjes thelbësore autoritative që ka të bëjë me:

1. Cilat burime ekonomike dhe obligime duhet të regjistrohen si asete apo borxhe
2. Cilat ndryshime në asete dhe borxhe duhet të regjistrohen
3. Si duhet të maten asetet dhe borxhet si dhe ndryshimet në to
4. Çfarë informata duhet të zbulohen dhe si
5. Çfarë deklarata financiare duhet të përgatiten

PASTRIMI I PARAVE

- Pastrimi i parave është procesi me anë të të cilit burimi i paligjshëm i procedimeve fshihet me anë të transaksioneve financiare apo me anë të mjeteve tjera për ta bërë që procedimet ilegale të duken të ligjshme.

PATENTA

- Monopol ligjor që i siguron një shpikësi një afat disa vjecar të drejtën ekskluzive për të prodhuar, përdorur apo shitur shpikjen e tij.

PËRDORIMI VENDOR

- Sa i përket mallrave, konsumimi, përdorimi apo sistemim tjetër në Kosovë.

PËRJASHTIM

- Zbritje apo anulim i pagesës së detyrimeve dhe tatimeve doganore që normalisht aplikohen dhe paguhen.

PËRJASHTIMI NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMET

- Lirimi i mallrave, për përdorim brenda vendit, nga detyrimet e importit dhe tatimet, pavarësisht nga klasifikimi tarifor normal i tyre apo nga detyrimet normale, me kusht që ato të jenë importuar në rrethana specifike dhe për qëllime të caktuara.

PËRMES FATURËS SË NGARKIMIT

- Një kontratë, faturë shoqëruese malli apo faturë e lëshuar nga një transportues apo bartës që kontrollon mënyrën e dërgesës nga pika apo vendi i prodhimit apo origjinës deri te porti i importimit apo përtej (edhe pse transporti mund të zgjerohet në më shumë se dy linja të transportit) dhe tregon origjinën dhe destinacionin e ngarkesës, ngarkuesin, marrësin e ngarkesës, itinerarin dhe normën apo normat e zbatueshme.

PËRPUNIM I BRENSHËM

- Procedurë doganore nën të cilën mallra të caktuara mund të sillen në territorin doganor të liruara me kusht nga pagesa e detyrimeve dhe tatimeve të importit, duke u bazuar në atë se këto mallra janë të dedikuara për prodhim, procesim ose riparim dhe eksport të mëvonshëm

PËRPUNIM I JASHTËM

- Procedura doganore nën të cilën mallrat që janë në qarkullim të lirë në një territor doganor, mund të eksportohen përkohësisht për përpunim, procesim apo riparim jashtë vendit dhe pastaj ri-importohen me lirim total apo të pjeshëm nga detyrimet e importit dhe tatimet.

PËRPUNIMI I MALLRAVE PËR PËRDORIM BRENDIA VENDIT

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat e importuara mund të prodhohen, përpunohen ose të punohen, para lejimit për përdorim shtëpiak dhe nën kontroll doganor, deri në atë masë sa shuma e detyrimeve dhe tatimeve të zbatueshme të importit ndaj produkteve të përfituara në këtë mënyrë është më e ulët se ajo që do të jetë e zbatueshme për mallrat e importuara.

PËRSHKRIMI I TARIFËS

- Përshkrimi i një artikulli apo produkti në përputhje me terminologjinë e përdorur në nomenklaturën tarifore.

PERSON

- Edhe personat fizik edhe juridik, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, dhe përfshin një shoqëri, kompani publike të kufizuar, partneritet apo një shoqatë; gjithashtu përveç nëse konteksti qartazi tregon qëllim të kundërt, fjalët që kanë apo bartin një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër, si dhe njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas.

PERSONELI DIPLOMATIK

- Përfaqësuesit e qeverive të huaja që kanë të drejtë në përjashtime të veçanta sipas Konventës së Vjenës.

PERSONI I AFERM

Do të thotë, për qëllim të dispozitave të vlerësimit doganor, që personat janë të lidhur me njëri tjetrin në qoftë se:

- (a) ata janë persona fizik të afërm me lidhje gjaku, martesë apo adoptimi, sipas kuptimit të këtyre termave në ligjet tjera kombëtare;
- (b) ata janë persona fizik dhe njëri prej tyre është zyrtar ose drejtor i një personi juridik i cili është i kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ana e tjetrit;
- (c) çdo person i tillë është zyrtar ose drejtor i dy korporatave, shoqatave, ortakërive apo organizatave tjera të njëjta;
- (d) ata janë partnerë;
- (e) njëri është punëdhënës i tjetrit
- (f) ata kontrollojnë, direkt ose indirekt, të njëjtin person ose janë të kontrolluar nga i njëjti person
- (g) njëri e kontrollon, direkt apo indirekt, tjetrin apo është i kontrolluar nga tjetri;
- (h) të dy së bashku e kontrollojnë, direkt ose indirekt, një person të tretë;
- (i) cilido person tjetër zotëron, direkt apo indirekt, ose kontrollon pesë për qind ose më shumë prej aksionevetë votimit ose aksione të personit të tillë; ose
- (j) njëri zotëron, direkt apo indirekt, ose kontrollon pesë për qind ose më shumë të aksioneve të votimit apo hiseve të tjetrit.

Një person, qoftë fizik ose juridik, do të mirret se kontrollon një person tjetër juridik, për qëllime të përkufizimeve nëse ai person ka kapacitet për të imponuar ndonjë ndalesë ose kufizim, ose kufizim ose edhe mund të ushtrojë drejtim mbi personin tjetër juridik.

PERSONI I INTERESUAR NË LËVIZJEN E MALLRAVE, PERSONAVE OSE MJETEVE TË TRANSPORTIT

Do të thotë një nga këto:

(a) një pronar ose një operator i një mjete transportues që mbart ose transporton mallra ose persona, ose të dyja, nga territori doganor në një pikë jashtë territorit doganor, ose nga një pikë jashtë territorit doganor në territorin doganor, për qëllime tregtare; apo agjenti i një pronari apo operatori të tillë.

(b) një operator udhëtimi (duke qenë një person i cili organizon transportin, trajtimin, ose transportin e mallrave ose personave, ose të dyjave, nga territori doganor në një pikë jashtë territorit doganor, ose nga një pikë jashtë territorit doganor në territorin doganor, për qëllime tregtare) ose agjent i një operatori të udhëtimit.

(d) një operator biznesi që shet, paketon, magazinon apo transporton mallra që do të transportohen nga territori doganor në një pikë jashtë territorit doganor.

(e) çdo person apo klasë e personave të përfshirë në ndonjë mënyrë tjetër në bartjen, trajtimin apo transportimin e mallrave, personave, ose të dyjave, nga territori doganor në një pikë jashtë territorit doganor, ose nga një pikë jashtë territorit doganor në territorin doganor, për qëllime tregtare, qofshin persona apo klasë personash të përshkruar për qëllime të këtij Kodi Doganor.

PESHA BRUTO

- Pesha e tërësishme e mallrave, paketimi dhe konteineri, të gatshme për transport.

PESHA NETO

- Vetëm pasha e mallit pa mbështjellës; p.sh. pesha e përmbajtjes së kanaqes pa peshën e kanaqes.

PIJET ALKOHOLIKE

- Alkoholi, vera, birra dhe birrat e lehta.

PILOT

- Do të thotë, në lidhje me fluturaket, personi përgjegjës për fluturaken e tillë.

PLOMBË

- Një copë metali apo material tjetër që përdoret për të bashkuar dy skaje të një pajisje fiksimi në një mënyrë të sigurt.

POROSI BLERJE

- Oferta me shkrim e blerësit për furnizuesin që përmend të gjitha kushtet dhe konditat e transaksionit të propozuar.

PORT

- Një vend i destinuar për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave apo udhëtarëve të lundrave (ky mund të jetë Brenda një porti natyral, në një breg, ose në një lumë, apo brenda ujit të strehuar të prodhuar nga bankinat artificiale; vend ku mund të jetë e vendosur një zyrë doganore për mbledhjen e detyrimeve dhe kontrollin e importeve dhe eksporteve.

PORT I HYRJES

- Vend i caktuar në të cilin është i caktuar një oficer i doganës me autoritet që të pranojë hyrjen e mallrave, të grumbullojë detyrime, dhe të zbatojë dispozitat e ndryshme të ligjeve të doganave dhe navigimit.

PRANIMI I PËRKOHSHËM

- Procedurë doganore nën të cilën mallra të caktuara mund të sjellen në një territor të caktuar, me kusht lirohen nga pagesa e detyrimeve të importit dhe tatimeve; Mallrat e tilla duhet të importohen për një qëllim specifik dhe duhet të jenë të destinuara për riekportim brenda një periudhe të caktuar dhe pa pësuar asnjë ndryshim, përveç zhvlerësimit normal për shkak të përdorimit të mallrave.

PRANIMI I PËRKOHSHËM PËR PËRPUNIM TË BRENDSHËM

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat e caktuara mund të sjellen brenda territorit doganor të liruara me kusht nga pagesa e detyrimeve të importit dhe tatimeve; mallrat e tilla duhet të jenë të destinuara për ri-eksportim brenda një periudhe të caktuar pas nënshtrimit të prodhimit, përpunimit apo riparimit.

PROCEDURA DOGANORE

- Veprime ligjore për të siguruar lirimin e mallrave të importuar apo eksportuar nga kontrolli doganor; trajtim i aplikuar nga Doganat për mallin që i nënshtrohet kontrollit doganor.

PROCEDURA E MAGAZINIMIT DOGANOR

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat e importuara vihen nën kontroll doganor në një vend të përcaktuar (magazinë doganore) pa paguar detyrimet dhe tatimet e importit.

PROCEDURA E RIKTHIMIT TË PAGESËS SË DOGANËS

- Procedure doganore që kur eksportohen mallrat, siguron kompensim (të plotë ose të pjesërishtëm) që do të bëhet në lidhje me detyrimet dhe/ose tatimet e paguara të importit për mallrat, apo për materialet përbërëse të tyre ose që janë përdorur për prodhimin e tyre.

PROCEDURA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE PËRGJATË BREGUT

Procedurë Doganore nën të cilën:

(a) Mallrat në qarkullim të lirë, dhe

(b) Mallrat e importuara që nuk janë deklaruar me kusht që ato të transportohen me një lundër tjetër nga ajo lundra me të cilën kanë arritur në territorin doganor janë të ngarkuara në bordin e lundrës në një vend në territorin doganor dhe transportohen në një vend tjetër në territorin e njëjtë doganor ku ato janë më pas të pangarkuara.

PRODUKTE KOMPENZUESE

- Produktet e marrura, si duhet, brenda apo jashtë vendit gjatë apo si rezultat i riprodhimit, procesimit apo riparimit të mallrave përkohësisht të pranuar për përpunim të brendshëm apo për mallra përkohësisht të eksportuara për përpunim të jashtëm.

PRONAR

- Përfshinë secilin person që ligjërisht vepron në emër të pronarit të mallrave të importuara apo eksportuara.

PROTOKOLLI (kundërtregti)

- Termi protokoll përdoret për të identifikuar dokumentin që shet aranzhimet brenda një transaksioni kundër-tregtar. Përdoret sidomos në aranzhimet kundër-blerëse.

QARKULLIM I BRENDSHËM

- Bartja e personave të hipur ose mallrave të ngarkuara në territorin doganor për zbritje apo shkarkim brenda territorit të njëjtë doganor.

QARKULLIMI KUFITAR (ose tregtia ndër kufitare)

- Importimet dhe eksportimet e kryera ndërmjet banorëve të dy zonave kufitare që gjenden pranë njëra tjetrës.

QEVERIA

Do të thotë Qeveri e një vendi dhe përfshin:

- (a) Çfarëdo qeverie shtetërore, provinciale, komunale apo qeveri tjetër lokale apo rajonale në vend
- (b) Cilido person, agjencion apo institucion që vepron për apo në emër të qeverisë, ose me autoritet ligjor që rrjedh nga ligjet e nxjerra nga qeveria e vendit apo shtetit
- (c) Çfarëdo bashkimi i shteteve sovrane, anëtare e së cilit është vendi

RAPORTI PËR MBËRRITJEN APO “RAPORTI I NISJES”

- Varësisht prej rastit, do të thotë çdo deklaratë që kërkohet të bëhet apo paraqitet në Doganë me rastin e mbërritjes apo nisjes së mjeteve të transportit për qëllime komerciale, nga personi përgjegjës për mjetin e transportit për qëllime komerciale, dhe që përmban të dhënat e domosdoshme në lidhje me mjetin e transportit për qëllim komercial, përdorimin dhe itinerarin e tij, ngarkesat, magazinat, ekuipazhin apo udhëtarët.

REZERVAT

- Mallrat e destinuara për konsum nga ana e udhëtarëve apo ekuipazhit në bord të lundrave, fluturakeve apo trenave, qoftë të shitura ose jo.

Mallrat e domosdoshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e lundrave, fluturakeve apo trenave, përfshirë karburantin dhe lubrifikantet, por duke përjashtuar pjesët e këmbimit dhe pajisjet; dhe

Mallrat për shitje udhëtarëve apo ekuipazhit të lundrave dhe fluturakeve me qëllim të tokëzimit.

RI-EKSPORTIMI

- Eksportimi i mallrave nga një territor doganor në të cilin ishin importuar më parë.

RI-IMPORTIMI

Importimi në një territor doganor i mallrave të eksportuara më parë nga ai territor.

RI-IMPORTIMI NË GJENDJE TË NJËJTË

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat që janë eksportuar dhe kanë qenë në qarkullim të lirë apo kanë qenë prodhime kompenzuese mund të mirren në shfrytëzim vendor pa detyrime dhe tatime importi, me kusht që ato nuk i janë nënshtruar ndonjë prodhimi, përpunimi apo riparimi jashtë vendit.

çdo shumë e pagueshme si rezultat i ripagesës, shlyerjes apo lirimit me kusht nga detyrimet dhe tatimet apo të ndonjë subvencioni ose shume tjetër të dhuruar në eksport, duhet të paguhet.

RI-PAGESË

- Kthim, i plotë ose i pjesshëm, i detyrimeve dhe tatimeve të paguara për mallrat dhe shlyerje, e plotë ose e pjesshme, e detyrimeve dhe tatimeve aty ku pagesa nuk është bërë.

RIKTHIM I PAGESËS SË DOGANËS

- Shuma e detyrimeve të importit që kthehen sipas procedurës së rikthimit të pagesës së dogbanes.

ROLL ON, ROLL OFF (Ro-Ro)

- Një kategori e anijeve të dizajnuara për ngarkim dhe shkarkim të ngarkesave që rrotullohen në rrota, dhe siç thotë edhe emri futet me makinë në kuvertë dhe nxirret me makinë.

RREGULLAT E ORIGJINËS

- Dispozita të veçanta, të zhvilluara nga parimet e përcaktuara nga legjislacioni kombëtar apo marrëveshjet ndërkombëtare ("kriteri i origjinës"), që zbatohen nga një vend për të përcaktuar origjinën e mallrave.

RREGULLORE

- Do të thotë dispozitë ligjore e bërë nga Dogana ose autoritete tjera administrative sipas autoritetit të deleguar me ligj që krijon ose kufizon të drejtat dhe obligimet.

RREGULLORJA TEKNIKE

- Rregullorja teknike është dokument i cili lëshohet nga një organ i autorizuar që i detajizon karakteristikat e produktit, metodat e prodhimit, përfshirë dispozitat administrative, për të cilat pajtueshmëria është e detyrueshme.

RRUGË E APROVUAR NGA DOGANA

- Çdo rrugë, hekurudhë, rrugë ujore dhe çfarëdo rruge tjetër (tubacione, etj) që në përputhje me dispozitat doganore të Shtetit, duhet të shfytëzohet për importim, transit doganor apo eksportim të mallrave.

RUAJTJA E PËRKOHSHME E MALLRAVE

- Ruajtja e mallrave nën kontroll doganor në lokalet dhe në hapërsirat e mbyllura apo të hapura të specifikuara nga Doganat (magazina të përkohshme) në pritje të deponimit të deklaratës së mallrave.

SENDET PERSONALE

- Artikuj (të ri ose të përdorur) të cilët udhëtari me arsye mund t'i kërkojë për përdorim personal gjatë udhëtimit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e udhëtimit dhe të çdo qëndrimi të ndërmjetëm, por duke përjashtuar mall të importuar apo eksportuar për qëllime komerciale.

SHENJAT E MARRËSIT TË NGARKESËS

- Një symbol i vendosur në pakot e eksportit me qëllim identifikimi; përgjithësisht përmban një: trekëndësh, katror, rreth, diamante, kryq me shkronja dhe/apo numra si dhe portin e shkarkimit.

SHENJAT E PORTIT

- Një grumbull identifikues shkronjash, numrash dhe/ose simbolesh gjeografike që përcillen nga emri i portit të destinacionit, të cilat janë të vendosura në dërgesat e eksportit. Kërkesat qeveritare mund të jenë më shumë ose më pak të rrepta sa i përket shenjave të portit.

SHENJIMI

- Tregues i qartë i vendit të origjinës apo informative tjera të kërkuara për mallin e importuar.

SHËRBIMI DOGANOR OSE DOGANAT

- Departament i qeverisë përgjegjës për ekzekutimin e kontrollit doganor të mallrave të importuara dhe të eksportuara dhe për administrimin e Kodit Doganor, Ligjit për Tarifat Doganore, dhe akteve tjera relevante.

SHËRBIMI POSTAR

- Një organ publik ose privat i autorizuar nga Qeveria për të ofruar shërbime ndërkombëtare të rregulluara me Aktin e Unionit Postar Univerzal aktualisht në fuqi.

SHITJA NË TRANZIT

- Malli i cili ishte transportuar në një vend te një blerës apo marrës i caktuar, por ishte shitur nga ky blerës apo marrës derisa malli ishte ende në rrugë.

SHKAKTARI I MUNDSHËM

- Fakte dhe rrethana mjaft të forta në vetvete për të bërë një person të arsyeshëm dhe të vetëdijshëm që të besojë se një shkelje e ligjit ka ndodhur.

SHKËMBIMI ELEKTRONIK I TË DHËNAVE

- Linjë elektrike ndërmjet palëve që lehtëson rrjedhjen dhe procesimin e informatave ndërmjet palëve në transaksionet ndërkombëtare.

SHKRESA POSTARE

- Letrat, panorama, fletët e shtypura, literature për të verbërit dhe pakot e vogla të përshkruara si shkresa postare në Aktet e Unionit Postar Univerzal aktualisht në fuqi.

SHOQATA GARANTUESE

- Shoqatë e aprovuar nga Autoritetet Doganore të palës kontraktuese në marrëveshjet ndërkombëtare, për të garantuar pagesën e shumës ligjore përkatëse, sipas kushteve të kësaj marrëveshje, te Autoritetet Doganore të kësaj pale kontraktuese, dhe që e bashkuar në zingjirin garantues.

SHPEDITERI

- Vepron si agjent për importuesin apo eksportuesin gjatë lëvizjes së ngarkesës. Përveç aranzhimit për transport, shpediteri mund të procesojë dokumentet e kërkuara, aranzhon magazinimin e dërgesave, paketimin, transportimin, konsolidimin dhe sigurimin, si dhe ofron këshilla në lidhje me letërkreditë, licencat, inspektimet dhe çështjet tjera të lidhura ngusht me dërgesën e ngarkesës.

SHPENZIMET E PAKETIMIT

- Kostoja e të gjithë mbështjellësve apo rrethuesve (duke përjashtuar instrumentet e trafikut ndërkombëtar), mbulesave të çfarëdo natyre dhe paketimeve, qoftë të punës ose të materialeve, që përdoren për paketimin e mallit në gjendje paketime të gatshme për transport në vendin e importimit.

SHTESAT STATUTORE

- Ato shtesa që mund të shtohen në bazë të dispozitave të Marrëveshjes së OBT-së për vlerësim doganor në çmimin realisht të paguar apo të pagueshëm: shpenzimet e paketimit, komisioni i shitjes, ndihmat, honoraret etj.

SHUARJA E DETYRIMEVE TË IMPORTIT DHE TATIMEVE

- Heqja dorë nga pagesa, e plotë apo e tërësishme, e detyrimeve të importit dhe tatimeve aty ku pagesa nuk është bërë.

SHUMA E LEJUAR

- Një shumë e dhënë, zakonisht ka të bëjë me përjashtime.

SIGURIA

- Ajo që siguron në mënyrë të kënaqshme Doganën se obligimi ndaj Doganës do të përbushet. Siguria përshkruhet si “e përgjithshme” kur siguron se detyrimet që rrjedhin nga disa operacione do të përmbushen. Siguri mund të jetë garancioni bankar ose i sigurimeve, kolaterali, etj.

SIGURIMI DETAR

- Sigurimi i cili do t’u kompensojë pronarin për mallrat që transportohen përmes detit në rast të humbjes që nuk mund të rikuperohet ligjërisht nga bartësi.

SIGURIMI I RREZIKUT TË LLOGARIVE TE ARKETUESHME

- Formë sigurimi që mbron shitësin nga humbja si pasojë e mosplotësimit të zotimeve nga ana e blerësit.

SISTEMI I HARMONIZUAR (S.H.)

- Konventa Ndërkombëtare mbi Përshkrimin e Harmonizuar të Mallit dhe Sistemit të Kodimit që administrohet nga Organizata Botërore e Doganave.

Emri i zakonshëm për sistemin ndërkombëtar të kodimit numerik për klasifikimin e mallrave (zakonisht përdoret në tarifën doganore kombëtare – për shembull, TARIK në Kosovë).

SISTEMI I PËRGJITHSHËM I PREFERENCAVE (SPP)

- Metodë e ofrimit të trajtimit me lirim nga detyrimet doganore për artikujt e zgjedhur të importuar direkt nga vendet përfituese në zhvillim (VPZH). Rregullat e origjinës mund të ndryshojnë nga vendi në vend.

STANDARD (Dokument)

- Standardi është një dokument që përshkruan veçoritë e rëndësishme të një produkti, shërbimi apo sistemi dhe kërkesat thelbësore që duhet t'i përmbushë. Pajtueshmëria është vullnetare.

STANDARD (Matje)

- Një instrument, material referues, ose sistem matjeje që ka për qëllim përcaktimin ose riprodhimin e një ose më shumë vlerave të një sasive që do të shërbejnë si referencë.

STATUS JO I PRIVILEGJUAR (zonat e lira)

- Kategori e mbetur për mallin në një zonë të lirë që nuk ka status të privilegjuar apo të kufizuar nga zona. Artikujt e përbërë tërësisht apo që rrjedhin tërësisht nga malli i jo-privilegjuar klasifikohen dhe vlerësohen për gjendjen në momentin e transferimit ligjor për konsumim në territorin doganor.

TARIFA

- Lista e plotë ose "plani" i mallrave me tarifa doganore të aplikueshme për t'u paguar ose ngarkuar për secilin artikull në listë; së bashku me rregullat dhe rregulloret drejtuese.

TARIFAT E APLIKUARA / NORMAT E APLIKURARA

- Detyrat që janë të ngarkuara në të vërtetë mbi importet. Këto mund të jetë më të ulëta se normat e detyruara.

TARIFË PREFERENCIALE

- Tarifë, ose normë tarifore, që imponon norma më të ulëta të detyrimeve për mallrat e importuara nga një vend i caktuar. (Tarifa preferenciale mund të ofrohet në bazë të një marrëveshjeje tregtare rajonale si CEFTA, ose marrëveshje dypalëshe për tregti të lirë).

TË ARDHURA

- Të hyra të prodhuara nga rishitja, disponimi, apo përdorimi i mallit të importuar që i shkojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi shitësit.

TË DREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE

Të drejtat që kanë të bëjnë me:

- Punimet letrare, artistike dhe shkencore
- Performancat e artistëve performues, fonogramet dhe emitimet
- Zbulimet në të gjitha fushat e përpjekjeve njërëzore
- Zbulimet shkencore
- Dizajnet industrial
- Market tregtare, market e shërbimeve dhe emrat komercial dhe emërtimet
- Mbrojtja kundër konkurrencës jo të drejtë, dhe të gjitha të drejtat tjera që rezultojnë nga aktivitetet intelektuale në fushat e industrisë, shkencës, letërsisë dhe artit.

TEJKALIM

- Gjatë kontrollit zyrtari doganor mund të zbulojë sasi më të madhe se ajo e faturuar ose artikujt e pafaturuar nuk janë përfshirë në paketën kontrolluese.

TËRHEQJA NË GJENDJE TË NJËJTË

- Tërheqje e lejuar për një mall të importuar, të eksportuar në gjendje të njëjtë si kur ishte importuar, apo shkatërruar nën mbikqyrje doganore dhe që nuk është përdorur në vend para eksportimit apo destinimit të tillë.

TERRITORI (Territori Doganor)

- Do të thotë, në lidhje me Kosovën, territori në të cilin do të zbatohen ligjet doganore të tij dhe përfshin edhe zonat për përpunim të eksporteve të vendosura në Kosovë.

TESTIMI

- Para vënjes së një produkti apo shërbimi në dispozicion për konsumim, duhet të testohet për t'u siguruar se është në përputhje me specifikimet e përfshira në standardin dokumentar që detajizon cilësinë e tij.

TITUJT E TARIFAVE (APO NËNTITUJT)

- Përcaktimi tekstual në nomenklaturën tarifore për një mall të vetëm apo një grup mallrash të lidhura.

TRAGETI

Zakonisht, lundër udhëtarësh që bën udhëtime të shpeshta ndërmjet porteve detare dhe gjithashtu mund të transportojë vetura të udhëtarëve

TRAJTIMI APO PËRDORIMI I LEJUAR NGA DOGANA PËR MALLRAT

- Nënkupton: a) vendosjen e mallrave nën një procedurë doganore; b) hyrjen e tyre në një zonë të lirë apo depo të lirë; c) ri-eksportimin e tyre nga Kosova; d) asgjësimin e tyre; e) Heqjen dorë në dobi të autoritetit doganor.

TRANSAKSIONET E LIDHURA

- Janë transaksionet ndërmjet palëve të lidhura.

TRANSFERI ELEKTRONIK I FONDEVE

- Sistem i transferimit të fondeve nga një llogari në tjetrën përmes mjeteve elektronike.

TRANSFERIM

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat transferohen, nën kontroll doganor, nga mjete transportues i importimit në mjete transportues për eksportim brenda hapërsirës së një zyre doganore që është edhe zyrë e importimit edhe e eksportimit.

TRANSPARENCA

- Masa në të cilën ligjet, rregulloret, marrëveshjet, dhe praktikrat që ndikojnë në tregtinë ndërkombëtare janë të hapura, të qarta, të matshme dhe të verifikueshme.

TRANSPORTI DHE SIGURIMI TË PAGUAR DERI TE VENDI I EMERUAR I DESTINIMIT

- Në Transportin dhe Sigurimin e Paguar deri te, shitësi/eksportuesi kryen obligimet e mallrave për eksport, i dërgon ato te bartësi, dhe është përgjegjës për pagesën e transportit dhe sigurimit deri te vendi i emëruar i destinimit. Sidoqoftë, pasi që malli të jetë dërguar te bartësi, blerësi është përgjegjës për të gjitha shpenzimet shtesë.

Shitësi është përgjegjës për prokurimin dhe pagimin e mbulesës së sigurimit. Termi CIP mund të përdoret te të gjitha llojet e transportit duke përfshirë edhe atë multimodal.

TRANSPORTI MULTIMODAL

- Transportim që përfshin së paku dy modele transporti, siç janë transporti përmes hekurudhës dhe përmes detit; transferi i ngarkesës nga një model transporti në një model tjetër.

TRANSPORTUES I BRENDSHËM

- Linjë transportuese që bart qarkullimin për eksport apo import ndërmjet porteve dhe pikave të brendshme.

TRANZITI

- Procedurë doganore nën të cilën mallrat e importuara transferohen nën kontroll doganor nga një zyrë doganore deri te një zyrë tjetër doganore.

TREGTI PËRGJATË BREGUT

- Tregti ndërmjet dy porteve detare të një vendi; lundra duhet të lëvizë përgjatë bregut kur shkon nga një port detar në një port detar tjetër të të njëjtit vend.

TREGTIA ELEKTRONIKE

- Prodhimi, reklamat, shitja dhe shpërndarja e produkteve nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacionit.

TRETMAN KOMBËTAR

- Për t'u lejuar individëve dhe firmave të huaja të njëjtat mundësi konkurrence, përfshirë qasjen në treg, si ato që janë në dispozicion të palëve vendore (standard i OBT-së).

TVSH

- Do të thotë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar i përkufizuar dhe përshkruar në Ligjin për TVSH të Kosovës.

UDHËTAR

(1) çdo person që hyn përkohësisht në territorin e një vendi në të cilin ai ose ajo nuk banojnë normalisht ("jo-rezident"), dhe

(2) çdo person që kthehet në territorin e një vendi në të cilin ai ose ajo banon normalisht, pasi ka qenë jashtë shtetit përkohësisht ("banor që kthehet").

UNION DOGANOR

Entitet i formuar nga një territor doganor duke zëvendësuar dy apo më shumë territore dhe që në gjendjen përfundimtare ka këto karakteristika:

- Tarifë doganore të jashtme të përbashkët dhe legjislacion të përbashkët dhe të harmonizuar për zbatim të kësaj tarife;
- Mungesa e detyrimeve dhe tatimeve doganore që kanë efekt ekuivalent në tregtinë ndërmjet vendeve që formojnë unionin doganor, për produktet me origjinë prej këtyre vendeve apo produktet e vendeve tjera të cilat iu kanë përmbajtur formaliteteve të importit dhe për të cilat detyrimet dhe tatimet doganore janë mbledhur apo janë garantuar dhe nëse ato nuk kanë përfituar tërheqje të plotë apo të pjesërishme të këtyre detyrimeve dhe tatimeve;
- Eliminimi i rregullimeve restriktive të tregtisë përbrenda unionit doganor.

UNIONI DOGANOR

- Union doganor është i formuar dhe përbëhet nga anëtarët të cilët pajtohen për tregti të lirë brenda unionit dhe për tarifa të përbashkëta të jashtme. Unionet doganore themelohen me marrëveshje tregtare rajonale.

UNIONI UNIVERZAL POSTAR

- Organizatë ndër-qeveritare e themeluar në vitin 1874 me Traktatin e Bernit si “Unioni i Përgjithshëm Postar”, e cila në vitin 1878 u riemërua në “Unioni Postar Univerzal (UPU)” dhe e cila që nga viti 1948 është agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara.

VEND

- Do të thotë territori i një kombi apo shteti dhe nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, përfshin territorin e varur ndaj një vendi.

VENDI I ORIGJINËS SË MALLRAVE

- Vendi në të cilin mallrat janë kultivuar apo prodhuar, ose kur mallrat janë nënshtruar një ndryshim substancial por kanë ruajtur përmbajtjen e tyre thelbësore, sipas kriterëve të vendosura me qëllim të aplikimit të tarifave doganore të restriksioneve kuantitative apo masave tjera lidhur me tregtinë.

VENDIMI

- Akt individual me të cilin Doganat vendosin për një çështje të lidhur me ligjin doganor.

VEPRAT PIRATE

- Zakonisht i referohet mallrave të prodhuara duke shkelur të drejtën autoriale.

VLERA E KONFISKIMIT

- Vlera e konstatuar nga autoritetet doganore kur malli që është subjekt i konfiskimit nuk është më në dispozicion për t'u konfiskuar.

VLERA E LLOGARITUR

- Bazë vlerësimi që përdoret kur vlera e transaksionit, vlera e transaksionit e mallit identik apo të ngjashëm, apo vlera e zbritur nuk mund të përcaktohet. Vlera e llogaritur e mallit të importuar është shuma e: 1. Kostos së materialeve dhe fabrikimit dhe e përpunimeve tjera të aktivizuara për prodhimin e mallit të importuar; 2. Shumës për profit dhe shpenzime të përgjithshme që është e barabartë me atë që zakonisht reflektohet në shitje të mallrave të klasit dhe llojit të njëjtë me mallrat që vlerësohen që janë bërë nga prodhuesi në vendin e eksportimit për eksport në vendin e importimit; 3. Kosto e transportimit te porti apo vendi i importimit, pagesat për ngarkim dhe trajtim si dhe për sigurim nëse përfshihet në legjislacionin kombëtar.

VLERA E TRANSAKSIONIT

- Çmimi realisht i paguar, ose i pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë të nënshtruara kushteve të caktuara dhe ndryshimeve.

VLERA E ZBRITUR

- Metodë e OBT-së për vlerësimin që përdoret nëse vlera e transaksionit e mallit të importuar, mallit identik apo mallit të ngjashëm nuk mund të përcaktohet. Vlera e zbritur është vlera e rishitjes në vend, me zbritjen e sendeve të caktuara. Ky çmim i përdorur varet nga koha dhe gjendja kur shitet malli përkatës në vendin e importimit.

VLERA VENDORE

- Çmimi me të cilin një artikull i importuar është apo do të ofrohej për shitje në një transaksion të pavarur në vendin e importimit.

VLERËSIM

- Një përcaktim nga zyrtari i autorizuar doganor, i vlerës së tatuar të mallit të importuar.

VLERËSIMI

- Akti i konstatimit të vlerës së një sendi; vlera e llogaritur e një sendi.

VLERËSIMI I DETYRIMEVE DHE TATIMEVE

- Përcaktimi i shumës së detyrimeve dhe tatimeve të pagueshme.

VLERËSIMI I KONFORMITETIT

- Procedurat e vlerësimit të konformitetit janë aktivitete teknike të tilla si testimi, verifikimi, inspektimi, certifikimi dhe akreditimi të cilat vërtetojnë se produktet apo proceset përmbushin kërkesat e përcaktuara në rregullat dhe standardet.

VULA DOGANORE

- Pajisje që përbëhet nga vula dhe mbërthyesi të cilët janë të bashkuar në mënyrë të sigurtë. Vulat doganore vendosen në lidhje me procedura të caktuara doganore (tranzitit doganor në veçanti) përgjithësisht për të parandaluar apo tërhequr vëmendjen për çfarëdo ndërhyrje të pa-autorizuar në sendet e vulosura.

ZBATIMI

- Sigurimi i respektimit jo-vullnetar dhe zbulimi i mos-rrespektimit të ligjeve që rregullojnë importimin dhe eksportimin e mallit, kontrabandës dhe artikujve të ndaluar.

ZGJIDHJA ADMINISTRATIVE E KUNDËRVAJTJEVE DOGANORE

- Procedura e vendosur nga legjislacioni kombëtarë me të cilin autoritetet e doganës autorizohen që të vendosin kundërvajtje doganore ose duke shfrytëzuar pushtetin në atë fushë ose me gjetjen e zgjidhjes së kompromisit.

ZGJIDHJA ADMINISTRATIVE TË KUNDËRVAJTJES DOGANORE

- Procedurë e përcaktuar nga legjislacioni kombëtar, sipas të cilës autoritetet doganore janë të autorizuara për të zgjidhur një kundërvajtje doganore me vendim apo përmes ujdisë së kompromisit.

ZHDOGANIMI (I MALLRAVE)

- Kompletimi i formaliteteve doganore të domosdoshme për të lejuar lirin e mallit nga kontrolli doganor-për eksport, përdorim të brendshëm apo për t'u vendosur nën procedura tjera doganore.

ZONA E KONTROLLIT DOGANOR

- Pjesë e territorit doganor në të cilin posedimi dhe lëvizja e mallrave mund të jetë subjekt i masave të veçanta të kontrollit doganor.

ZONË E LIRË

- Pjesë e territorit të një shteti ku të gjitha mallrat e paraqitura mirren se janë, sa i përket detyrimeve dhe tatimeve të importit, jashtë territorit doganor.

ZVOGËLIM

- Zbritje e negociuar nga shuma origjinale e vlerësuar si gjobë apo dëmtim i likuidueshëm.

ZYRA DOGANORE

- Cdo zyrë në të cilën mund të kryhen të gjitha apo disa formalitete që parashikon legjislacioni doganor.

ZYRA E NGARKIMIT

- Zyrë doganore nën autoritetin e së cilës mirren masa të caktuara paraprake për të lehtësuar fillimin e operacionit të tranzitit doganor në një zyrë nisjeje.

ZYRA E RRUGËS

- Zyrë doganore ku mallrat importohen apo eksportohen gjatë një operacioni tranzit doganor.

ZYRË DESTINACIONI DOGANORE

- Zyra doganore ku përfundon operacioni i tranzitit doganor.

ZYRË DOGANORE

- Njësi administrative doganore kompetente për kryerjen e formaliteteve doganore dhe hapësirat apo sipërfaqet tjera të miratuara për atë qëllim nga autoritetet kompetente.

ZYRË NISJE DOGANORE

- Zyra doganore ku fillon operacioni i tranzitit doganor.